FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 221

Tiranë – E enjte, 17 dhjetor 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 137/2020 datë 16.11.2020	Për buxhetin e vitit 2021	17201
Vendim i Kuvendit nr. 76/2020, datë 17.12.2020	Për rrëzimin e dekretit nr. 11 866, datë 11.12.2020, të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr. 137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021""	17245
Vendim i Kuvendit nr. 77/2020, datë 17.12.2020	Për zgjedhjen e zotit Altin Binaj anëtar i Gjykatës Kushtetuese	17245
Vendim i Kuvendit nr. 78/2020, datë 17.12.2020	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e ministrit të Brendshëm	17246
Vendim i Kuvendit nr. 79/2020, datë 17.12.2020	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	17246
Vendim i Kuvendit nr. 80/2020, datë 17.12.2020	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e ministrit të Brendshëm	17246
Vendim i Kuvendit nr. 81/2020, datë 17.12.2020	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	17247
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 34, datë 16.12.2020	Për disa ndryshime në ligjin nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar	17247
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 35, datë 16.12.2020	Për një shtesë në aktin normativ nr.1, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike", miratuar me ligjin nr.18/2020	17255
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1008, datë 25.11.2020	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë	17255
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.1040, datë 25.11.2020	Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje	17257

LIGJ
Nr. 137/2020

PËR BUXHETIN E VITIT 2021

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 158 të Kushtetutës dhe të nenit 30 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
BUXHETI

Neni 1

Buxheti për vitin 2021 është:

Të ardhurat	484 106	milionë lekë;
Shpenzimet	592 801	milionë lekë;
Deficiti	108 695	milionë lekë.

Ai përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale: sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i ish-pronarëve.

Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2021 është:

Të ardhurat	358 125	milionë lekë;
Shpenzimet	466 820	milionë lekë;
Deficiti	108 695	milionë lekë.

Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2021 është:

Të ardhurat	56 826	milionë lekë
Nga të cilat:		
- transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	18 450	milionë lekë;
- transferta e pakushtëzuar sektoriale	8 100	milionë lekë;
- transferta specifike për emergjencat civile	500	milionë lekë;
- të ardhura të tjera	29 776	milionë lekë;
Shpenzimet	56 826	milionë lekë.

Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2021 është:

l. Sigurimi i detyrueshëm, programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta.

Të ardhurat gjithsej	137 133	milionë lekë;
Nga të cilat:		
- kontributet	83 675	milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	51 238	milionë lekë;
- transferta për indeksimin e pensioneve	2 220	milionë lekë;
Shpenzimet	137 133	milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe për kategoritë e veçanta të personave të vetëpunësuar. Për vitin 2021 teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve dhe programeve të sigurimit shoqëror të detyrueshëm e suplementar, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Sigurimi suplementar

Të ardhurat gjithsej	7 532	milionë lekë;
Nga të cilat:		
- kontributet	1 796	milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	5 556	milionë lekë;
- transferta për indeksimin e pensioneve	180	milionë lekë;
Shpenzimet	7 532	milionë lekë.

Fondi për indeksimin e pensioneve është parashikuar 2 400 milionë lekë. Përdorimi i këtij

fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2 500 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.

Nga teprica e të ardhurave dhe fondi rezervë i sigurimeve shoqërore përdoren 4 000 milionë lekë për financimin e shpenzimeve si më sipër.

Neni 5

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2021 është:

Të ardhurat gjithsej	47 506	milionë lekë;
Nga të cilat:		
- kontributet dhe të tjera	14 084	milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	33 422	milionë lekë;
Shpenzimet	47 506	milionë lekë.

Fondi për rimbursimin e medikamenteve nuk tejkalon tavanin prej 11700 milionë lekësh, përfshirë detyrimet e prapambetura, nga i cili 1200 milionë lekë përdoren për rimbursimin e medikamenteve për kurimin e COVID-19. Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.

Nga fondi rezervë i sigurimeve të kujdesit shëndetësor përdoren 2 000 milionë lekë për financimin e shpenzimeve si më sipër.

Neni 6

Buxheti i fondit për kompensimin në vlerë të pronarëve për vitin 2021 është:

Të ardhurat gjithsej	3 000	milionë lekë;
Nga të cilat:		
- të ardhura të tjera	1 000	milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	2 000	milionë lekë;
Shpenzimet	3 000	milionë lekë.

Neni 7

Fondi i rindërtimit për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019 prej 28 000 milionë lekësh përdoret për të përballuar kostot për projektet e miratuara dhe të pafinancuara në vitin 2020, si dhe për projektet e reja.

Ky fond shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar, të miratuar në tabelat 1 dhe 3, të përmendura në nenet 11 dhe 15 të këtij ligji.

Çdo e ardhur në formë granti me destinacion përballimin e pasojave të tërmetit rrit në të njëjtën masë të ardhurat dhe shpenzimet e fondit të rindërtimit, duke shtuar kufijtë e përcaktuar në nenet 1, 2, 3 dhe 11, si dhe kufijtë e miratuar në tabelat 1, 3 dhe 4 të përmendura në nenet 11 dhe 15 të këtij ligji.

Në fund të vitit buxhetor, fondet e pashpenzuara trashëgohen në vitin pasardhës dhe përdoren për të njëjtin qëllim.

Neni 8

Përdorimi dhe investimi i fondit rezervë të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

KREU II
BURIMET PËR MBËSHTETJEN E SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË SHTETIT

Neni 9

Të ardhurat e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Grantet	20 353	milionë lekë
Të ardhurat tatimore	316 172	milionë lekë;
Të ardhurat jotatimore	21 600	milionë lekë.

Neni 10

Deficiti faktik i buxhetit të shtetit, i cili nuk duhet të rezultojë më tepër sesa deficiti i përcaktuar në nenin 1 të këtij ligji, mund të financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të

brendshme deri në kufirin maksimal prej 49 900 milionë lekësh.

Pjesa tjetër e financimit të deficitit faktik të buxhetit të shtetit financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja, si dhe ndryshimit pakësues ose shtues të gjendjes së llogarisë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë dhe llogarive të fondeve speciale në bankat e nivelit të dytë.

Vlera indikative e financimit, nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja, është rreth

13 052 milionë lekë, ku përfshihen huamarrjet dhe ripagesat me vlera të përafërta indikative, si më poshtë:

- Huamarrje afatgjata të destinuara për projekte me vlerë rreth 24 178 milionë lekë;
- Huamarrje në formën "mbështetjeje buxhetore" nga institucione financiare ndërkombëtare me vlerë rreth 29 764 milionë lekë;
- Ripagesa të principalit me vlerë rreth - 40 890 milionë lekë.

Vlera indikative e financimit, nëpërmjet përdorimit të gjendjes së akumuluar në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë, është rreth 39 742 milionë lekë.

Vlera indikative e financimit nëpërmjet përdorimit të gjendjes së akumuluar në llogaritë e fondeve speciale në bankat e nivelit të dytë është rreth 6 000 milionë lekë.

Çdo diferencë që mund të rezultojë midis financimit total neto nga burimet e ndryshme të përmendura në këtë nen dhe deficitit faktik të buxhetit të shtetit, në rast teprice akumulohet në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë, ose në rast mungese përdoret nga gjendja e kësaj llogarie.

Të ardhurat nga privatizimi, që mund të krijohen gjatë vitit 2021, përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e kufirit të huamarrjes neto nga burime të brendshme dhe pjesa tjetër përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale, e cila, automatikisht, rrit me të njëjtën masë kufirin e deficitit të buxhetit të shtetit, të përcaktuar në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji.

KREU III
SHPENZIMET E BUXHETIT TË SHTETIT

Neni 11

Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

- Shpenzime të buxhetit qendror	458 320	milionë lekë;
- Fondi rezervë i buxhetit	2 000	milionë lekë;
- Fondi për zgjedhjet parlamentare	1 000	milionë lekë;
- Fondi për studime dhe projektime	1 000	milionë lekë;
- Kontingjencë për risqet e borxhit	4 500	milionë lekë.

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, për shpenzime korrente dhe kapitale, është sipas tabelës 1 që i bashkëlidhet këtij ligji.

Në tabelat 1/1 dhe 1/2 janë kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, për shpenzime korrente dhe kapitale, përkatësisht për vitet 2022 dhe 2023. Transferta e pakushtëzuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore miratohet vetëm për vitin 2021.

Të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit, sipas zërave kryesorë, për dy vitet e mëparshme fiskale dhe tri vitet e ardhshme janë sipas tabelës 4, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mund të fillojnë procedurën e prokurimit që në muajin nëntor të vitit korrent nëse fondet janë akorduar/regjistruar në sistemin e thesarit për vitet 2021 dhe 2022, me kushtin që lidhja e kontratës të bëhet efektive vetëm pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Kriteret bazë, masa e përfitimit, mënyra e përdorimit të fondit prej 1000 milionë lekësh, të përcaktuar në programin buxhetor 04250 "Zhvillimi Rural duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agroindustrial dhe marketingun" në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimin Rural, për skemën e mbështetjes së naftës për bujqësinë, si dhe financimi i ngritjes së sistemit të shpërndarjes dhe monitorimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Numri i përgjithshëm i punonjësve në organikë është 83 749. Numri maksimal i punonjësve për çdo ministri dhe institucion qendror, i dhënë në tabelën 2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij, detajohet nga ministritë dhe institucionet qendrore në përputhje me strukturat e miratuara për çdo institucion varësie. Këshilli i Ministrave mund të rishpërndajë numrin e punonjësve ndërmjet institucioneve të përmendura në tabelën 2, në rastin e ristrukturimit të institucioneve ekzistuese ose krijimit të institucioneve të reja.

Numri rezervë, i parashikuar në tabelën 2, përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për krijimin e institucioneve të reja. Këshilli i Ministrave përcakton numrin maksimal të punonjësve me kontratë të përkohshme për çdo ministri dhe institucion qendror.

Për vitin 2021 nuk miratohet asnjë ndryshim në strukturat organike të njësive të qeverisjes qendrore me efekte financiare shtesë në koston e personelit, të përllogaritur sipas strukturës së miratuar, me përjashtim të institucioneve të reja.

Ky përcaktim përfshin edhe ato struktura, në të cilat paga për funksion jepet ose është sipas gradës përkatëse, ku çdo rritje në gradë do të bëhet efektive vetëm nëse nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në koston e përllogaritur sipas gradave të miratuara.

Fondi i veçantë i institucioneve buxhetore prej 250 milionë lekësh shpërndahet dhe përdoret sipas procedurave që përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat. Shumat e shpërndara nga ky fond shtojnë kufijtë e miratuar në tabelën 1, që përmendet në nenin 11 të këtij ligji.

Neni 13

Paga e Presidentit të Republikës është 257 000 lekë në muaj dhe rritet gjatë vitit sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Fondi rezervë prej 4 000 milionë lekësh përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për:

-raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme në masën 2 000 milionë lekë, nga i cili 560 milionë lekë për pagesën e naftëtarëve;

-përballimin e kostos së zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2021 në masën 1 000 milionë lekë;

-për hartimin e studimeve të projekteve të investimeve publike strategjike në masën 1000 milionë lekë.

Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4 500 milionë lekësh përdoret nga ministri përgjegjës për financat për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa.

Shumat e shpërndara nga fondi rezervë dhe kontingjenca për risqet e borxhit shtojnë kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11 të këtij ligji.

Neni 15

Transferta e pakushtëzuar, që buxheti qendror ia transferon pushtetit vendor, përfshin fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme shpërndahet ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore sipas formulës së paraqitur në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Shuma e transfertës së pakushtëzuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore paraqitet në tabelën 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Fondi rezervë nga totali i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme përdoret nga ministria përgjegjëse për financat në përputhje me kriteret e përcaktuara në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe programi për infrastrukturën vendore dhe rajonale përdoren sipas aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Transferta e pakushtëzuar sektoriale dhe transferta specifike për funksionet e reja të transferuara në bashki shpërndahet sipas anekseve 1 dhe 4, që i bashkëlidhen këtij ligji.

Numri i personelit administrativ të këshillit të qarkut nuk mund të jetë më shumë se 10.

Fondet e trashëguara nga vitet e mëparshme përdoren nga njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas rregullave të përcaktuara nga ministri përgjegjës për financat.

Neni 16

Fondet e buxhetit të shtetit për institucionet e arsimit të lartë shpërndahen në formën e grantit. Ky fond shpërndahet sipas kategorive:

a) granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë;

b) granti i mësimdhënies;

c) granti i punës kërkimore-shkencore dhe i veprimtarive krijuese.

Modeli i financimit për institucionet e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kriteret për përdorimin e granteve të politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë dhe granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese janë përcaktuar në nenet 111 dhe 113 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Fondi i projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë mund të shpërndahet edhe te njësitë e vetëqeverisjes vendore në ato raste kur me vendim të Këshillit të Ministrave ato përcaktohen autoritete kontraktore për realizimin e procedurave të prokurimit për studim-projektimin apo zbatimin e projektit për një ose disa institucione të arsimit të lartë. Në këto raste, çelja e fondit nga ministria përgjegjëse për financat bëhet pas paraqitjes së kërkesës nga njësia e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Detajimi i fondeve realizohet në përputhje me detyrën e projektimit apo projektin e zbatimit të paraqitur nga njësia e vetëqeverisjes vendore, e shoqëruar edhe me vendimin e organeve kolegjiale të kësaj njësie dhe/ose me vendimin e organeve kolegjiale të IAL-së, në rastin kur ato marrin përsipër bashkëfinancimin e projektit. Fondet e akorduara për njësitë e qeverisjes vendore sa më sipër trashëgohen në vitin pasardhës.

Neni 17

Kufiri i shpenzimeve, sipas tabelës 1 që i bashkëlidhet këtij ligji, mund të rishpërndahet gjatë vitit ndërmjet programeve brenda të njëjtit institucion buxhetor apo ndërmjet programeve të institucioneve të ndryshme nga Këshilli i Ministrave deri në masën 10 për qind të shumës së përgjithshme të shpenzimeve korrente apo shpenzimeve të përgjithshme kapitale, duke ruajtur totalin e shpenzimeve korrente dhe kapitale. Të drejtat e përcaktuara në nenin 44 të ligjit nr. 9636, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për rishpërndarjen e fondeve buxhetore, përcaktojnë treguesit e faktit në tabelat 1 dhe 4 të cituara në këtë ligj.

Neni 18

Tavani për vlerën totale të kontratave në përqindje të PBB-së për të gjitha projektet koncesionare/PPP-të ekzistuese dhe ato të kontraktuara rishtazi për vitin 2020, në përputhje me të dhënat e regjistrit të koncesioneve, është 49.8% e PBB-së. Çdo kontratë e re ndjek procedurat dhe rregullat e legjislacionit në fuqi për koncesionet/PPP-të.

Neni 19

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të stokut të borxhit të qeverisjes qendrore dhe atij të garantuar të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese për vitin 2021, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, është deri në 49 452 milionë lekë, i dhënë me hollësi si më poshtë:

- Për huamarrjen totale neto vjetore, përfshirë huamarrjen e brendshme dhe atë të huaj, deri në 62 952 milionë lekë.
- Për rritjen vjetore të garancive të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese, deri në (minus) -13 500 milionë lekë.

Stoku i borxhit publik vlerësohet të arrijë në 1 331 953 milionë lekë, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, i dhënë me hollësi si më poshtë:

- Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore 1 225 526 milionë lekë.
- Stoku i borxhit të garantuar nga qeverisja qendrore 55 628 milionë lekë.
- Stoku i borxhit të qeverisjes vendore 800 milionë lekë.

Neni 20

Në rast të disbursimit të ndonjë kredie shtesë në formën "mbështetje buxhetore" nga institucionet financiare ndërkombëtare, vlerat indikative respektive të përcaktuara në nenet 10 dhe 19 të këtij ligji mund të rriten automatikisht. Ndërkohë, niveli i deficitit të buxhetit të vitit 2021 mbetet i pandryshuar sipas përcaktimit në nenin 1 të këtij ligji.

Qeveria mund të akumulojë dhe mund të mbajë në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë çdo gjendje shtesë të likuiditetit që mund të krijohet dhe të mbartet për të financuar buxhetet e viteve fiskale pasardhëse, por në mbyllje të vitit buxhetor gjendja e akumuluar nuk duhet të kalojë vlerën mesatare prej dy muajsh kumulativë të shpenzimeve buxhetore.

Neni 21

Ngarkohet ministri përgjegjës për financat që të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2021.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 16.11.2020

Tab.1

BUXHETI 2021 SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

Kodi	Emertimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Financim i Brendshem	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
1	**Presidenca**	**242,500**	**6,000**	**0**	**6,000**	**248,500**
01120	Veprimtaria e Presidentit	242,500	6,000	0	6,000	248,500
2	**Kuvendi**	**1,035,160**	**118,000**	**0**	**118,000**	**1,153,160**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	414,000	118,000	0	118,000	532,000
01120	Veprimtaria Ligjvenese	621,160	0	0	0	621,160
3	**Kryeministria**	**398,000**	**200,000**	**130,000**	**330,000**	**728,000**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	398,000	200,000	130,000	330,000	728,000
5	**Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural**	**5,314,239**	**3,500,000**	**4,166,093**	**7,666,093**	**12,980,332**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	317,000	10,000	0	10,000	327,000
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,600,989	235,409	297,701	533,110	2,134,099
04240	Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes	660,000	2,020,591	1,212,641	3,233,232	3,893,232
04250	Zhvillimi Rural duke mbesht. Prodh. Bujq, Blek, Agroind dhe Market.	2,131,250	879,000	1,975,781	2,854,781	4,986,031
04860	Keshillimi dhe Informacioni Bujqesor	452,000	120,000	0	120,000	572,000
05470	Menaxhimi qendrueshem i tokes bujqesore	20,000	0	0	0	20,000
04230	Mbeshtetje per Peshkimin	133,000	235,000	679,970	914,970	1,047,970
6	**Ministria e Infrastruktures dhe Energjise**	**4,221,500**	**27,434,211**	**18,219,627**	**45,653,838**	**49,875,338**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	493,100	13,000	0	13,000	506,100
04520	Transporti rrugor	1,500,000	17,812,923	6,908,132	24,721,055	26,221,055
04540	Transporti Detar	105,000	50,000	0	50,000	155,000
04550	Transporti Hekurudhor	422,000	300,000	1,400,000	1,700,000	2,122,000
04560	Transporti Ajror	18,300	122,000	0	122,000	140,300
04610	Mbështetje për rrjetet e komunikacionit	0	0	20,000	20,000	20,000
06370	Furnizimi me Uje dhe Kanalizime	470,000	6,508,016	5,731,495	12,239,511	12,709,511
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	600,000	2,064,272	1,050,000	3,114,272	3,714,272
04320	Mbeshtetje per Energjine	106,000	250,000	2,890,000	3,140,000	3,246,000
04430	Mbeshtetje per Burimet Natyrore	157,000	125,000	0	125,000	282,000
04440	Mbeshtetje per Industrine	321,000	85,000	0	85,000	406,000
06180	Planifikimi Urban	29,100	104,000	220,000	324,000	353,100
10	**Ministria e Financave dhe Ekonomise**	**65,705,149**	**1,564,689**	**1,207,000**	**2,771,689**	**68,476,838**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	581,000	136,000	169,000	305,000	886,000
01120	Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	374,000	0	0	0	374,000
01130	Ekzekutimi i Pagesave te Ndryshme	300,000	0	0	0	300,000
01140	Menaxhimi i te Ardhurave Tatimore	2,440,000	303,000	0	303,000	2,743,000
01150	Menaxhimi i te Ardhurave Doganore	3,189,310	173,220	120,690	293,910	3,483,220
01160	Lufta kunder Transaksioneve Financiare Jo-Ligjore	79,000	2,000	0	2,000	81,000
04130	Mbeshtetje per Zhvillim Ekonomik	584,000	63,000	150,000	213,000	797,000
04160	Mbeshtetje per Mbikq. e Tregut, Infrast. e Ciles. dhe Pron. Industr.	307,740	24,000	0	24,000	331,740
10220	Sigurimi Shoqeror	51,600,099	0	0	0	51,600,099
10550	Tregu i Punes	2,235,000	65,000	0	65,000	2,300,000
04170	Inspektimi ne Pune	166,000	10,000	0	10,000	176,000
09240	Arsimi i Mesem (profesional)	2,040,000	488,469	767,310	1,255,779	3,295,779
06190	Strehimi	1,809,000	300,000	0	300,000	2,109,000
11	**Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise**	**37,764,073**	**4,150,000**	**300,003**	**4,450,003**	**42,214,076**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	667,000	55,000	0	55,000	722,000
09120	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	21,155,073	1,637,000	3	1,637,003	22,792,076
09230	Arsimi i Mesem (i pergjithshem)	6,237,000	962,000	0	962,000	7,199,000

Kodi	Emertimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Financim i Brendshem	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
09450	Arsimi Universitar	9,000,000	996,000	100,000	1,096,000	10,096,000
09770	Fonde per Shkencen	380,000	200,000	100,000	300,000	680,000
08140	Zhvillimi i Sportit dhe Rinise	325,000	300,000	100,000	400,000	725,000
12	**Ministria e Kultures**	**1,406,001**	**1,400,000**	**0**	**1,400,000**	**2,806,001**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	160,000	0	0	0	160,000
08220	Trashegimia Kulturore dhe Muzete	526,001	7,500	0	7,500	533,501
08230	Arti dhe Kultura	720,000	1,392,500	0	1,392,500	2,112,500
13	**Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale**	**67,890,905**	**2,451,700**	**1,110,000**	**3,561,700**	**71,452,605**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	376,687	5,000	0	5,000	381,687
07220	Sherbimet e Kujdesit Paresor	9,164,000	309,898	158,000	467,898	9,631,898
07330	Sherbimet e Kujdesit Dytesor	25,910,117	2,090,802	852,000	2,942,802	28,852,919
07450	Sherbimet e Shendetit Publik	3,207,741	21,000	0	21,000	3,228,741
07460	Sherbimi Kombetar i Urgjences	328,100	15,000	0	15,000	343,100
10430	Perkujdesi Social	27,869,260	10,000	100,000	110,000	27,979,260
01190	Rehabilitimi i te Perndjekurve Politik	1,035,000	0	0	0	1,035,000
14	**Ministria e Drejtesise**	**8,554,800**	**543,900**	**110,000**	**653,900**	**9,208,700**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	352,000	111,800	110,000	221,800	573,800
03310	Ndihma Juridike	73,000	2,000	0	2,000	75,000
01120	Publikimet Zyrtare	56,000	10,000	0	10,000	66,000
01130	Mjekesia Ligjore	80,000	1,000	0	1,000	81,000
03440	Sistemi i Burgjeve	5,418,000	400,900	0	400,900	5,818,900
03350	Sherbimi i Permbarimit Gjyqesor	163,000	10,000	0	10,000	173,000
01160	Sherbimet per çeshtjet e biresimeve	15,000	200	0	200	15,200
01180	Sherbimi i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave	2,244,000	6,000	0	6,000	2,250,000
03490	Sherbimi i Proves	153,800	2,000	0	2,000	155,800
15	**Ministria e Evropes dhe Puneve te Jashtme**	**2,551,876**	**43,000**	**80,780**	**123,780**	**2,675,656**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	132,600	7,000	0	7,000	139,600
01120	Mbeshtetje diplomatike jashte shtetit	2,123,776	15,000	0	15,000	2,138,776
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	195,500	0	0	0	195,500
01150	Mbeshtetja Institucionale per Procesin e Integrimit	100,000	21,000	80,780	101,780	201,780
16	**Ministria e Brendshme**	**19,361,000**	**881,000**	**618,868**	**1,499,868**	**20,860,868**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,227,000	67,849	0	67,849	1,294,849
03140	Policia e Shtetit	15,456,000	688,151	618,868	1,307,019	16,763,019
03150	Garda e Republikes	1,535,000	110,000	0	110,000	1,645,000
01160	Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara te Pushtetit Vendor	502,000	15,000	0	15,000	517,000
01170	Sherbimi i Gjendjes Civile	641,000	0	0	0	641,000
17	**Ministria e Mbrojtjes**	**19,628,300**	**5,010,500**	**300,000**	**5,310,500**	**24,938,800**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,190,300	120,000	0	120,000	1,310,300
02120	Forcat e Luftimit	5,670,000	3,057,500	0	3,057,500	8,727,500
09430	Arsimi Ushtarak	620,000	251,625	0	251,625	871,625
02150	Mbeshtetja e Luftimit	5,536,000	961,375	0	961,375	6,497,375
07340	Mbeshtetje per Shendetesine	1,016,000	200,000	0	200,000	1,216,000
10270	Mbeshtetje Sociale per Ushtaraket	5,200,000	0	0	0	5,200,000
10910	Emergjencat Civile	396,000	420,000	300,000	720,000	1,116,000
18	**Sherbimi Informativ Shteteror**	**1,810,000**	**50,000**	**0**	**50,000**	**1,860,000**
03520	Veprimtaria Informative Shteterore	1,810,000	50,000	0	50,000	1,860,000
19	**Drejtoria e Radio Televizionit**	**556,000**	**50,000**	**0**	**50,000**	**606,000**
08310	Sherbimet per shqiptaret jashte kufirit	220,000	0	0	0	220,000
08520	Projekte teknike per futjen e teknologjive te reja	216,000	50,000	0	50,000	266,000
08330	Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarekombetare	60,000	0	0	0	60,000
08340	Orkestra simfonike e RTSH dhe Kinematografise	60,000	0	0	0	60,000
20	**Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave**	**186,000**	**95,000**	**0**	**95,000**	**281,000**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	186,000	95,000	0	95,000	281,000
22	**Akademia e Shkences**	**115,950**	**1,000**	**0**	**1,000**	**116,950**
01520	Veprimtaria Akademike	115,950	1,000	0	1,000	116,950
24	**Kontrolli Larte i Shtetit**	**392,000**	**20,000**	**19,853**	**39,853**	**431,853**
01120	Veprimtaria Audituese e KLSH	392,000	20,000	19,853	39,853	431,853
26	**Ministria e Turizmit dhe Mjedisit**	**1,143,630**	**534,400**	**590,000**	**1,124,400**	**2,268,030**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	192,000	6,000	0	6,000	198,000
05320	Programe per mbrojtjen e Mjedisit	458,000	183,000	390,000	573,000	1,031,000
04260	Administrimi i Pyjeve	323,000	79,900	100,000	179,900	502,900
04760	Zhvillimi i Turizmit	170,630	265,500	100,000	365,500	536,130
28	**Prokuroria e Pergjithshme**	**2,240,000**	**180,000**	**0**	**180,000**	**2,420,000**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2,240,000	180,000	0	180,000	2,420,000
29	**Këshilli I Lartë I Gjyqësor**	**3,244,200**	**200,000**	**0**	**200,000**	**3,444,200**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	275,200	22,000	0	22,000	297,200
01140	Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë	8,500	0	0	0	8,500
03310	Buxheti Gjyqesor	2,960,500	178,000	0	178,000	3,138,500
30	**Gjykata Kushtetuese**	**151,000**	**4,000**	**0**	**4,000**	**155,000**
03320	Veprimtaria Gjyqesore Kushtetuese	151,000	4,000	0	4,000	155,000
31	**Agjensia Telegrafike Shqiptare**	**66,500**	**6,000**	**0**	**6,000**	**72,500**
08320	Veprimtaria Telegrafike e ATSH-se	66,500	6,000	0	6,000	72,500
35	**Këshilli I Lartë I Prokurorisë**	**147,000**	**17,000**	**0**	**17,000**	**164,000**
01110	Veprimtaria e KLP	147,000	17,000	0	17,000	164,000
40	**Partite Politike**	**150,200**	**0**	**0**	**0**	**150,200**
01110	Mbeshtetje per Partite Politike	140,000	0	0	0	140,000
01120	Mbeshtetje per Shoqatat	8,000	0	0	0	8,000
01130	Mbeshtetje per Organizatat e Veteraneve me Status	2,200	0	0	0	2,200
41	**Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar**	**470,000**	**30,000**	**0**	**30,000**	**500,000**
03390	Veprimtaria e SPAK	470,000	30,000	0	30,000	500,000
50	**Instituti Statistikes**	**706,000**	**219,600**	**0**	**219,600**	**925,600**
01320	Veprimtaria Statistikore	706,000	219,600	0	219,600	925,600
55	**Shkolla e Magjistratures**	**247,500**	**60,000**	**0**	**60,000**	**307,500**
09820	Veprimtaria Arsimore	247,500	60,000	0	60,000	307,500
56	**Fondi i Zhvillimit Shqiptar**	**0**	**7,300,000**	**7,229,000**	**14,529,000**	**14,529,000**
06210	Programe Zhvillimi	0	3,800,000	7,229,000	11,029,000	11,029,000
06220	Infrastruktura Vendore dhe Rajonale	0	3,000,000	0	3,000,000	3,000,000
04230	Programi "100 Fshatrat"	0	500,000	0	500,000	500,000

Kodi	Emertimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Financim i Brendshem	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
57	**Qendra Kombetare e Kinematografise**	**136,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**137,000**
08220	Mbeshtetja e veprimtarise kinematografike	136,000	1,000	0	1,000	137,000
63	**Institucionet e sistemit te drejtesise**	**657,900**	**69,000**	**0**	**69,000**	**726,900**
03320	Veprimtaria e Zyres se Inspektorit te Larte te Drejtesise	208,000	52,000	0	52,000	260,000
03330	Veprimtaria e rivlerësimit kalimtar të magjistratit	230,700	5,000	0	5,000	235,700
03340	Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar	149,000	8,000	0	8,000	157,000
03360	Veprimtaria e komisionerit publik	70,200	4,000	0	4,000	74,200
66	**Avokati i Popullit**	**116,000**	**3,000**	**0**	**3,000**	**119,000**
03320	Sherbimi i avokatise	116,000	3,000	0	3,000	119,000
67	**Komisioneri per Mbikqyrjen e Sherbimit Civil**	**57,800**	**2,000**	**0**	**2,000**	**59,800**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	57,800	2,000	0	2,000	59,800
73	**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**	**165,000**	**16,500**	**0**	**16,500**	**181,500**
01610	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	165,000	16,500	0	16,500	181,500
01620	Zgjedhjet e pergjithshme dhe lokale	0	0	0	0	0
76	**Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave**	**153,600**	**3,000**	**0**	**3,000**	**156,600**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	153,600	3,000	0	3,000	156,600
77	**Autoriteti i Konkurences**	**71,240**	**1,000**	**0**	**1,000**	**72,240**
04120	Mbikqyrja e tregut & Garantimi i konkurences	71,240	1,000	0	1,000	72,240
82	**Keshilli Kombetar i Kontabilitetit**	**12,700**	**1,000**	**0**	**1,000**	**13,700**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	12,700	1,000	0	1,000	13,700
87	**Institucione te tjera Qeveritare**	**4,279,823**	**1,417,500**	**256,776**	**1,674,276**	**5,954,099**
01320	Sherbime Qeveritare	200,000	80,000	0	80,000	280,000
01130	Sherbimi i Prokurimit Publik	61,300	1,000	0	1,000	62,300
01120	Sherbimi per diasporen	140,600	81,000	0	81,000	221,600
05640	Administrimi I ujrave	97,400	12,000	93,000	105,000	202,400
03310	Sherbimi i Avokatise Shteterore	223,400	2,000	0	2,000	225,400
01150	Sherbime te tjera	447,000	31,756	0	31,756	478,756
01140	e-Qeverisja	2,610,123	1,102,744	0	1,102,744	3,712,867
01330	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administrates Publike	366,500	106,000	163,776	269,776	636,276
08480	Mbeshtetje per Kultet Fetare	133,500	1,000	0	1,000	134,500
88	**Mbeshtetje per Shoqerine Civile**	**112,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**113,500**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	112,500	1,000	0	1,000	113,500
89	**Komisioneri për te Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**	**77,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**78,000**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	77,000	1,000	0	1,000	78,000
90	**Komisioni I Prokurimit Publik**	**70,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**71,000**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	70,000	1,000	0	1,000	71,000
91	**Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi**	**51,700**	**4,000**	**0**	**4,000**	**55,700**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	51,700	4,000	0	4,000	55,700
92	**Instituti i Studimeve te Krimeve te Komunizmit**	**32,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**33,000**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	32,000	1,000	0	1,000	33,000
95	**Autoriteti per Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit te Shtetit**	**95,176**	**12,000**	**90,000**	**102,000**	**197,176**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	95,176	12,000	90,000	102,000	197,176
	TOTALI	**251,787,922**	**57,604,000**	**34,428,000**	**92,032,000**	**343,819,922**

Tab. 1/1

BUXHETI 2022 SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

Kodi	Emertimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Financim i Brendshem	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
1	**Presidenca**	**248,000**	**6,000**	**0**	**6,000**	**254,000**
01120	Veprimtaria e Presidentit	248,000	6,000		6,000	254,000
2	**Kuvendi**	**1,060,160**	**48,000**	**0**	**48,000**	**1,108,160**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	416,000	48,000		48,000	464,000
01120	Veprimtaria Ligjvenese	644,160	0		0	644,160
3	**Kryeministria**	**425,000**	**50,000**	**130,000**	**180,000**	**605,000**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	425,000	50,000	130,000	180,000	605,000
5	**Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural**	**4,381,000**	**2,553,844**	**3,224,946**	**5,778,790**	**10,159,790**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	315,000	40,000		40,000	355,000
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,541,000	302,509	249,709	552,218	2,093,218
04240	Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes	690,000	863,491	0	863,491	1,553,491
04250	Zhvillimi Rural duke mbesht. Prodh. Bujq, Blek, Agroind dhe Market.	1,240,000	901,844	2,213,755	3,115,599	4,355,599
04860	Keshillimi dhe Informacioni Bujqesor	450,000	176,000		176,000	626,000
05470	Menaxhimi qendrueshem i tokes bujqesore	25,000	0		0	25,000
04230	Mbeshtetje per Peshkimin	120,000	270,000	761,482	1,031,482	1,151,482
6	**Ministria e Infrastruktures dhe Energjise**	**4,238,900**	**20,085,314**	**14,526,406**	**34,611,720**	**38,850,620**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	515,100	13,000		13,000	528,100
04520	Transporti rrugor	1,850,900	13,752,887	4,860,132	18,613,019	20,463,919
04540	Transporti Detar	110,000	50,000		50,000	160,000
04550	Transporti Hekurudhor	425,000	350,000	1,400,000	1,750,000	2,175,000
04560	Transporti Ajror	20,300	2,000	0	2,000	22,300
04610	Mbështetje për rrjetet e komunikacionit	0	0	0	0	0
06370	Furnizimi me Uje dhe Kanalizime	485,000	4,271,385	4,666,274	8,937,659	9,422,659
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	200,000	1,167,042	600,000	1,767,042	1,967,042
04320	Mbeshtetje per Energjine	102,000	200,000	2,780,000	2,980,000	3,082,000
04430	Mbeshtetje per Burimet Natyrore	170,000	90,000		90,000	260,000
04440	Mbeshtetje per Industrine	329,000	85,000		85,000	414,000
06180	Planifikimi Urban	31,600	104,000	220,000	324,000	355,600
10	**Ministria e Financave dhe Ekonomise**	**64,540,000**	**1,530,689**	**1,038,000**	**2,568,689**	**67,108,689**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	626,000	113,000	200,000	313,000	939,000
01120	Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	378,000	0		0	378,000

01130	Ekzekutimi i Pagesave te Ndryshme	300,000	0		0	300,000
01140	Menaxhimi i te Ardhurave Tatimore	2,500,000	283,000		283,000	2,783,000
01150	Menaxhimi i te Ardhurave Doganore	3,300,000	173,220	120,690	293,910	3,593,910
01160	Lufta kunder Transaksioneve Financiare Jo-Ligjore	85,000	2,000		2,000	87,000
04130	Mbeshtetje per Zhvillim Ekonomik	310,000	78,000	150,000	228,000	538,000
04160	Mbeshtetje per Mbikq. e Tregut, Infrast. e Ciles. dhe Pron. Industr.	338,000	22,000		22,000	360,000
10220	Sigurimi Shoqeror	52,358,000	0		0	52,358,000
10550	Tregu i Punes	1,790,000	81,000		81,000	1,871,000
04170	Inspektimi ne Pune	180,000	10,000		10,000	190,000
09240	Arsimi i Mesem (profesional)	2,065,000	518,469	567,310	1,085,779	3,150,779
06190	Strehimi	310,000	250,000		250,000	560,000
11	**Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise**	**39,610,000**	**4,171,000**	**300,000**	**4,471,000**	**44,081,000**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	708,000	55,000		55,000	763,000
09120	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	21,500,000	1,308,000		1,308,000	22,808,000
09230	Arsimi i Mesem (i pergjithshem)	6,540,000	1,162,000		1,162,000	7,702,000
09450	Arsimi Universitar	10,255,000	1,096,000	100,000	1,196,000	11,451,000
09770	Fonde per Shkencen	381,000	250,000	100,000	350,000	731,000
08140	Zhvillimi i Sportit dhe Rinise	226,000	300,000	100,000	400,000	626,000
12	**Ministria e Kultures**	**1,506,500**	**800,000**	**0**	**800,000**	**2,306,500**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	172,500	0		0	172,500
08220	Trashegimia Kulturore dhe Muzete	558,500	7,500		7,500	566,000
08230	Arti dhe Kultura	775,500	792,500		792,500	1,568,000
13	**Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale**	**62,995,028**	**1,401,700**	**810,000**	**2,211,700**	**65,206,728**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	430,000	3,000		3,000	433,000
07220	Sherbimet e Kujdesit Paresor	7,964,000	147,052	158,000	305,052	8,269,052
07330	Sherbimet e Kujdesit Dytesor	24,798,000	1,217,968	552,000	1,769,968	26,567,968
07450	Sherbimet e Shendetit Publik	3,214,428	13,680		13,680	3,228,108
07460	Sherbimi Kombetar i Urgjences	369,600	0		0	369,600
10430	Perkujdesi Social	25,169,000	20,000	100,000	120,000	25,289,000
01190	Rehabilitimi i te Perndjekurve Politik	1,050,000	0		0	1,050,000
14	**Ministria e Drejtesise**	**10,683,400**	**478,700**	**110,000**	**588,700**	**11,272,100**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	436,000	123,600	110,000	233,600	669,600
03310	Ndihma Juridike	80,500	2,000		2,000	82,500
01120	Publikimet Zyrtare	56,500	0		0	56,500
01130	Mjekesia Ligjore	81,600	1,000		1,000	82,600
03440	Sistemi i Burgjeve	5,450,000	340,900		340,900	5,790,900
03350	Sherbimi i Permbarimit Gjyqesor	164,000	3,000		3,000	167,000
01160	Sherbimet per çeshtjet e biresimeve	15,000	200		200	15,200
01180	Sherbimi i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave	4,244,000	6,000		6,000	4,250,000
03490	Sherbimi i Proves	155,800	2,000		2,000	157,800
15	**Ministria e Evropes dhe Puneve te Jashtme**	**2,667,276**	**43,000**	**80,780**	**123,780**	**2,791,056**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	146,500	7,000		7,000	153,500
01120	Mbeshtetje diplomatike jashte shtetit	2,203,776	15,000		15,000	2,218,776
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	211,000	0		0	211,000
01150	Mbeshtetja Institucionale per Procesin e Integrimit	106,000	21,000	80,780	101,780	207,780
16	**Ministria e Brendshme**	**19,435,000**	**817,000**	**618,868**	**1,435,868**	**20,870,868**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,196,000	70,849		70,849	1,266,849
03140	Policia e Shtetit	15,500,000	614,151	618,868	1,233,019	16,733,019
03150	Garda e Republikes	1,570,000	110,000		110,000	1,680,000
01160	Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara te Pushtetit Vendor	500,000	22,000		22,000	522,000
01170	Sherbimi i Gjendjes Civile	669,000	0		0	669,000
17	**Ministria e Mbrojtjes**	**21,699,139**	**6,639,500**	**3,900,000**	**10,539,500**	**32,238,639**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,190,300	120,000		120,000	1,310,300
02120	Forcat e Luftimit	6,080,000	4,286,500	3,500,000	7,786,500	13,866,500
09430	Arsimi Ushtarak	620,000	0		0	620,000
02150	Mbeshtetja e Luftimit	7,452,839	1,213,000		1,213,000	8,665,839
07340	Mbeshtetje per Shendetesine	856,000	200,000		200,000	1,056,000
10270	Mbeshtetje Sociale per Ushtaraket	5,200,000	0		0	5,200,000
10910	Emergjencat Civile	300,000	820,000	400,000	1,220,000	1,520,000
18	**Sherbimi Informativ Shteteror**	**1,830,000**	**50,000**	**0**	**50,000**	**1,880,000**
03520	Veprimtaria Informative Shteterore	1,830,000	50,000		50,000	1,880,000
19	**Drejtoria e Radio Televizionit**	**565,000**	**0**	**0**	**0**	**565,000**
08310	Sherbimet per shqiptaret jashte kufirit	250,000	0		0	250,000
08520	Projekte teknike per futjen e teknologjive te reja	190,000	0		0	190,000
08330	Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarekombetare	65,000	0		0	65,000
08340	Orkestra simfonike e RTSH dhe Kinematografise	60,000	0		0	60,000
20	**Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave**	**185,000**	**15,000**	**0**	**15,000**	**200,000**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	185,000	15,000		15,000	200,000
22	**Akademia e Shkences**	**107,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**108,500**
01520	Veprimtaria Akademike	107,500	1,000		1,000	108,500
24	**Kontrolli Larte i Shtetit**	**399,000**	**15,000**	**0**	**15,000**	**414,000**
01120	Veprimtaria Audituese e KLSH	399,000	15,000		15,000	414,000
26	**Ministria e Turizmit dhe Mjedisit**	**1,143,000**	**650,000**	**590,000**	**1,240,000**	**2,383,000**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	201,000	6,000		6,000	207,000
05320	Programe per mbrojtjen e Mjedisit	408,000	90,000	390,000	480,000	888,000
04260	Administrimi i Pyjeve	355,000	138,500	100,000	238,500	593,500
04760	Zhvillimi i Turizmit	179,000	415,500	100,000	515,500	694,500
28	**Prokuroria e Pergjithshme**	**2,240,000**	**130,000**	**0**	**130,000**	**2,370,000**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2,240,000	130,000		130,000	2,370,000
29	**Këshilli I Lartë I Gjyqësor**	**3,252,700**	**200,000**	**0**	**200,000**	**3,452,700**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	275,200	15,000		15,000	290,200
01140	Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë	8,500	0	0	0	8,500
03310	Buxheti Gjyqesor	2,969,000	185,000		185,000	3,154,000
30	**Gjykata Kushtetuese**	**156,500**	**4,000**	**0**	**4,000**	**160,500**
03320	Veprimtaria Gjyqesore Kushtetuese	156,500	4,000		4,000	160,500
31	**Agjensia Telegrafike Shqiptare**	**67,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**68,500**
08320	Veprimtaria Telegrafike e ATSH-se	67,500	1,000		1,000	68,500
35	**Këshilli I Lartë I Prokurorisë**	**145,000**	**10,000**	**0**	**10,000**	**155,000**
01110	Veprimtaria e KLP	145,000	10,000		10,000	155,000
40	**Partite Politike**	**150,200**	**0**	**0**	**0**	**150,200**
01110	Mbeshtetje per Partite Politike	140,000	0		0	140,000

01120	Mbeshtetje per Shoqatat	8,000	0		0	8,000
01130	Mbeshtetje per Organizatat e Veteraneve me Status	2,200	0		0	2,200
41	**Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar**	**470,000**	**10,000**	**0**	**10,000**	**480,000**
03390	Veprimtaria e SPAK	470,000	10,000		10,000	480,000
50	**Instituti Statistikes**	**560,000**	**15,600**	**0**	**15,600**	**575,600**
01320	Veprimtaria Statistikore	560,000	15,600		15,600	575,600
55	**Shkolla e Magjistratures**	**190,000**	**60,000**	**0**	**60,000**	**250,000**
09820	Veprimtaria Arsimore	190,000	60,000		60,000	250,000
56	**Fondi i Zhvillimit Shqiptar**	**0**	**6,000,000**	**5,540,000**	**11,540,000**	**11,540,000**
06210	Programe Zhvillimi		2,600,000	5,540,000	8,140,000	8,140,000
06220	Infrastruktura Vendore dhe Rajonale		2,900,000		2,900,000	2,900,000
04230	Programi "100 Fshatrat"		500,000		500,000	500,000
57	**Qendra Kombetare e Kinematografise**	**161,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**162,000**
08220	Mbeshtetja e veprimtarise kinematografike	161,000	1,000		1,000	162,000
63	**Institucionet e sistemit te drejtesise**	**593,900**	**6,000**	**0**	**6,000**	**599,900**
03320	Veprimtaria e Zyres se Inspektorit te Larte te Drejtesise	195,000	2,000		2,000	197,000
03330	Veprimtaria e rivlerësimit kalimtar të magjistratit	194,200	2,000		2,000	196,200
03340	Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar	134,000	2,000		2,000	136,000
03360	Veprimtaria e komisionerit publik	70,700	0		0	70,700
66	**Avokati i Popullit**	**117,500**	**2,000**	**0**	**2,000**	**119,500**
03320	Sherbimi i avokatise	117,500	2,000		2,000	119,500
67	**Komisioneri per Mbikqyrjen e Sherbimit Civil**	**58,800**	**2,000**	**0**	**2,000**	**60,800**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	58,800	2,000		2,000	60,800
73	**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**	**136,000**	**1,500**	**0**	**1,500**	**137,500**
01610	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	136,000	1,500		1,500	137,500
01620	Zgjedhjet e pergjithshme dhe lokale	0	0		0	0
76	**Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave**	**158,600**	**3,000**	**0**	**3,000**	**161,600**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	158,600	3,000		3,000	161,600
77	**Autoriteti i Konkurences**	**77,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**78,500**
04120	Mbikqyrja e tregut & Garantimi i konkurences	77,500	1,000		1,000	78,500
82	**Keshilli Kombetar i Kontabilitetit**	**12,700**	**1,000**	**0**	**1,000**	**13,700**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	12,700	1,000		1,000	13,700
87	**Institucione te tjera Qeveritare**	**4,712,696**	**1,330,153**	**243,000**	**1,573,153**	**6,285,849**
01320	Sherbime Qeveritare	200,000	30,000		30,000	230,000
01130	Sherbimi i Prokurimit Publik	59,800	1,000	0	1,000	60,800
01120	Sherbimi per diasporen	145,573	31,000		31,000	176,573
05640	Administrimi I ujrave	107,500	10,000	93,000	103,000	210,500
03310	Sherbimi i Avokatise Shteterore	218,400	2,000		2,000	220,400
01150	Sherbime te tjera	437,800	28,253		28,253	466,053
01140	e-Qeverisja	3,042,123	1,120,900		1,120,900	4,163,023
01330	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administrates Publike	370,000	106,000	150,000	256,000	626,000
08480	Mbeshtetje per Kultet Fetare	131,500	1,000		1,000	132,500
88	**Mbeshtetje per Shoqerine Civile**	**123,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**124,000**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	123,000	1,000		1,000	124,000
89	**Komisioneri për te Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**	**71,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**72,000**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	71,000	1,000		1,000	72,000
90	**Komisioni I Prokurimit Publik**	**74,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**75,000**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	74,000	1,000		1,000	75,000
91	**Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi**	**53,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**54,000**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	53,000	1,000		1,000	54,000
92	**Instituti i Studimeve te Krimeve te Komunizmit**	**36,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**37,500**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	36,500	1,000		1,000	37,500
95	**Autoriteti per Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit te Shtetit**	**95,651**	**2,000**	**0**	**2,000**	**97,651**
87	01120		4	TVSH, Detyrim doganore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	**0**
87	01120		5	Nga te ardhurat e veta	0	0	0	0	0	0	0	0	0	**0**
87	01120	**Fondi i Zhvillimit per Diasporen**	1	Çelje nga buxheti	0	0	0	0	0	0	0	0	53,481	**53,481**
87	01120		2	Financim i huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	**0**
87	01120		3	Kostot lokale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	**0**
87	01120		4	TVSH, Detyrim doganore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	**0**
87	01120		5	Nga te ardhurat e veta	0	0	0	0	0	0	0	0	0	**0**
87	01120	**Qendra e Studimeve dhe Publikimeve per Arbereshet**	1	Çelje nga buxheti	16,600	1,000	7,400	0	0	0	0	0	3,519	**28,519**
87	01120		2	Financim i huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	**0**
87	01120		3	Kostot lokale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	**0**
87	01120		4	TVSH, Detyrim doganore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	**0**
87	01120		5	Nga te ardhurat e veta	0	0	0	0	0	0	0	0	0	**0**
87	01120	**Totali**			**45,600**	**5,200**	**89,800**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**81,000**	**221,600**

Tab.5 *në 000/lekë*

Të tjera shpenzime të papërfshira në buxhetet e ministrive dhe institucioneve	Totali
Fondi rezervë dhe kontigjencë i Këshillit të Ministrave	**14,650,000**
Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave	*4,000,000*
Fondi kontigjencë për politika pensionesh	*2,400,000*
Fondi kontigjencë për ruajtjen e defiçitit	
Fondi i veçantë për pagat	*250,000*
Rezervë për rritjen e pagave	*8,000,000*
Kontigjencë për investime	*0*
Interesat	**43,800,000**
Për borxhin e brendshëm	*24,300,000*
Për borxhin e huaj	*15,000,000*
Rezervë	*4,500,000*
Shpenzimet e Pushtetit Vendor	**56,825,768**
Nga të ardhurat e veta	*25,425,768*
Granti për pushteti vendor	*27,050,000*
Nga të ardhurat nga transferimi i rentës	*900,000*
Nga të ardhurat jo-tatimore	*2,700,000*
Financimi i huaj vendor dhe të tjera të mbartura	*750,000*
Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	**2,550,000**
Shpenzime nga të ardhurat e arsimit të lartë	**1,600,000**
Investime nga të ardhurat jashtë limitit të arsimit të lartë	**1,000,000**
Të ardhurat e fondeve speciale	**100,555,040**
Huadhenie për energjinë	**0**
Fondi i rindërtimit	**28,000,000**
Totali	**248,980,809**

Tab.6

ne 000/leke

	Funksioni	600 Pagat	601 Kontrib. e Sigurimeve Shoqerore	602 Mallra dhe Sherbime	603 Subvecionet	604 Te Tjera Transferta Korrente Brendshme	605 Transferta Korrente te Huaja	606 Transferta per Buxhetet Familiare dhe Individet	230 Shpenzime Kapitale te Patrupezuara	231 Shpenzime Kapitale te Trupezuara	Totali 2020
01	Shërbimet e Përgjithshme Publike	13,284,895	2,077,016	9,615,490	200,000	3,307,774	850,703	1,276,904	169,418	4,116,350	**34,898,550**
02	Mbrojtja	4,840,000	810,000	5,281,000	0	0	0	275,000	0	4,018,875	**15,224,875**
03	Rendi dhe Siguria Publike	20,877,045	3,439,133	4,530,422	0	8,000	12,500	320,500	6,260	2,161,659	**31,355,519**
04	Çështjet Ekonomike	3,146,891	596,168	2,968,288	400,000	339,625	15,300	1,762,877	485,249	38,427,299	**48,141,697**
05	Mbrojtja e Mjedisit	339,260	56,820	169,320	0	10,000	0	0	12,000	666,000	**1,253,400**
06	Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit	67,500	11,400	640,200	380,000	0	0	1,809,000	258,134	29,748,649	**32,914,883**
07	Shëndetësia	2,899,487	479,245	2,399,310	0	47,506,004	423,699	2,000	5,000	3,641,700	**57,356,445**
08	Argëtimi, Kultura dhe Çeshtjet Fetare	819,089	136,951	273,550	0	1,181,400	52,011	0	0	1,858,000	**4,321,001**
09	Arsimi	23,607,190	3,882,754	1,879,171	0	9,106,340	50,000	1,154,118	0	5,562,407	**45,241,980**
10	Mbrojtja Sociale	1,203,160	209,950	704,500	570,000	142,380,002	4,000	27,700,000	2,000	893,000	**173,666,612**
	*Shpenzime të tjera të paklasifikuara**										***148,425,768***
	Totali	**71,084,517**	**11,699,437**	**28,461,251**	**1,550,000**	**203,839,145**	**1,408,213**	**34,300,399**	**938,061**	**91,093,939**	**592,800,731**

* Në zërin "Shpenzime të tjera të paklasifikuara" (Totali) janë përfshirë: (i) pagesat për shërbimin e borxhit, (ii) kontigjenca për politika pagash dhe pensionesh, (iii) fondi rezervë, dhe (iv) shpenzimet e pushtetit vendor (v) fondi i rindërtimit

ANEKS 1

TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR, FORMULA E NDARJES SË FONDEVE, KRITERET DHE KOEFICIENTËT E VITIT 2021

1. Transferta e pakushtëzuar

Transferta e Pakushtëzuar (TP) rregullohet nga Ligji nr. 68, datë 27.04.2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", i cili përcakton madhësinë dhe mënyrën e ndarjes për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV). Si rregull i përgjithshëm, transferta e pakushtëzuar ka për qëllim t'u sigurojë njësive të vetëqeverisjes vendore diferencën mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur (kapaciteti fiskal). Duke qenë se NJVQV-të janë të ndryshme për sa i përket nevojave dhe kapacitetit fiskal, në një sistem efikas dhe të drejtë të ndarjes së transfertës së pakushtëzuar duhet të merren parasysh diferencat tek të dy dimensionet.

Për vitin 2021, transfertat në buxhetin e njësive të vetëqeverisjes vendore janë:

-Transferta e pakushtëzuar e cila përbëhet nga:

a) Pjesa e Përgjithshme që rezulton nga zbatimi i pikës 2 të nenit 23 të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", i cili përcakton se madhësia e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2021 është jo më pak se 1% e prooduktit të brendshëm bruto dhe jo me pak se ajo e vitit 2020, ndërkohë mbështetur në Produktin e Brendshëm Bruto të afektuar nga situata Covid-19, transferta do të ishte rreth 1.4 miliard lekë më pak.; dhe

b) Pjesa Sektoriale prej 7,85 miliard lekë nga shtesa që rezulton si pasojë e zbatimit të pikës 3 të nenit 95 të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", për përfundimin e periudhës tranzitore për financimin me transferta specifike të funksioneve të decentralizuara nga ky ligj, dhe zbatimi i pikës 4 të nenit 23 të Ligjit 68 datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" që rregullon konvertimin e transfertave specifike për funksionet e decentralizuara rishtazi në nivel vendor në transfertë të pakushtëzuar sektoriale.

-Transferta specifike prej 500 mlionë lekë për mbrojtjen civile. Ky fond është shpërndarë me një formulë e cila bazohet në peshën specifike që zë buxheti i çdo bashkie ndaj totalit të buxhetit të të gjitha bashkive.

Në transfertën e pakushtëzuar të parashikuar për vitin 2021, që rezulton nga përcaktimi ligjor i madhësisë minimale jo më të vogël se një vit më parë ose prej 18.2 miliard lekë, do të shtohen edhe fondet prej rreth 7,85 miliard lekë, për financimin e funksioneve të reja të cilat për periudhën 2016-2018, janë financuar nëpërmjet transfertave specifike. Nga 1 janari i vitit 2019, transfertat specifike u kthyen në transfertë të pakushtëzuar sektoriale e cila përdoret në autonomi nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Po ashtu, në vitin 2021 do ju akordohen bashkive 500 milion lekë si transfertë specifike për funksionin e "Mbrojtjes civile". Në total, për vitin 2021, transferta e pakushtëzuar do të jetë 26.55 miliard lekë.

Formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar përcaktohet në nenin 24 të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore". Formula identifikon nevojat për shpenzime të bashkive duke u bazuar tek popullsia relative, dendësia e popullsisë (që reflekton diferencat në koston e ushtrimit të funksioneve ndërmjet bashkive) dhe tek numri faktik i fëmijëve në kopshte dhe nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki. Përveç ekualizimit të kostove të shërbimeve që bëhet nëpërmjet komponentit të dendësisë, formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar sjell edhe ekualizimin e kapacitetit fiskal (të matur nga të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore), të cilat mblidhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata tatimore qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatim i thjeshtuar i fitimit mbi biznesin e vogël, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të pasurisë për pasuritë e paluajtshme të shitura nga personat juridikë.

2. Shuma totale e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2021

Në zbatim të pikës 2 dhe 4 të nenit 23 të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", dhe pikës 3 të nenit 95 të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", **madhësia e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2021 është 26,55 miliard**, dhe përbëhet nga pjesa e përgjithshme dhe pjesa sektoriale që mbulon funksionet e decentralizuara në vitin 2016.

Transferta e pakushtëzuar për një bashki ose qark është e barabartë me shumën përkatëse që rezulton nga aplikimi i formulës për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë dhe qarqet sipas parashikimit të Ligjit nr. 68 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", datë 27.04.2017 dhe fondeve të ndara sipas çdo bashkie për funksionet e transferuara (decentralizuara) në vitin 2016.

	TOTALI I TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR (PJESA I + PJESA II)	**26,550,000,000**
I	**Pjesa e Përgjithshme – Ligji për Financat e Vetëqeverisjes Vendore**	**18,200,000,000**
1	**Produkti i Brendshëm Bruto i parashikuar për vitin 2021**	**1,682,637,000,000**
2	**Transferta e pakushtëzuar për vitin 2021, në % ndaj PBB-së të parashikuar**	**1.08%**
3	**Transferta e Pakushtëzuar për vitin 2021, në Lekë**	**18,200,000,000**
4	**Transferta e pakushtëzuar për tu shpërndarë sipas formulës në vitin 2021**, pas zbritjes së fondeve si më poshtë:	**16,663,042,548**
5	*Fondi rezervë*	*100,000,000*
6	*Fondet për Konviktet dhe Qendrat e Shërbimeve Sociale*	*588,964,712*
7	*Fondet për rrugët rurale të transferuara nga Qarqet tek Bashkitë*	*520,992,740*
8	*Mbështetje për reformën në financat e arsimit parashkollor*	*327,000,000*
II	**Pjesa Sektoriale – Funksionet e Decentralizuara me Ligjin "Për Vetëqeverisjen Vendore".**	**7,850,000,000**
1	*Fondet për personelin mësimor në kopshte në arsimin parashkollor*	*3,712,238,000*
2	*Fondet për personelin mbështetës në kopshte dhe arsimin parashkollor*	*1,076,195,000*
3	*Fondet për personelin mbështetës në arsimin parauniversitar*	*489,637,000*
4	*Fondet për personelin dhe shpenzimet operative për funksionin e mbrojtjes nga zjarri*	*1,220,539, 000*
5	*Fondet për personelin dhe shpenzimet operative për funksionin e administrimit të pyjeve*	*350,284,000*
6	*Fondet për personelin dhe shpenzimet operative për funksionin e ujitjes dhe kullimit*	*907,318,000*
7	*Fondet për qendrat e shërbimeve sociale*	*61,790,000*
8	*Fondet për klubet shumësportësshe "Partizani dhe Studenti"*	*32,000,000*
III	**Transferta specifike**	**500,000,000**
1	*Mrojtja civile*	*500,000,000*
IV	**Transferta e pakushtëzuar dhe specifike për tu shpërndarë me formulë në vitin 2021 (I.4+I.8+II.1+III.1)**	**21,202,280,548**

Pjesa e Përgjithshme e Transfertës së Pakushtëzuar (TP) për vitin 2021 është 18,200,000,000 Lekë, e njëjtë me atë të vitit 2020. Gjithsej transferta e pakushtëzuar së bashku me specifiken që shpërndahet nëpërmjet formulës është 21,202,280,548 lekë, pas zbritjes së fondeve për konviktet, shërbimet sociale, për rrugët rurale dhe për mbështetjen e reformës në arsimin parashkollor. Deri para vitit 2016, fondet për konviktet, shërbimet sociale dhe për disa kritere të tjera, përfshiheshin në transfertën e pakushtëzuar përfundimtare të bashkive respektive. Me hyrjen në fuqi të formulës së re të ndarjes së transfertës së pakushtëzuar, meqenëse ndarja e fondeve për këto funksione nuk ishte pjesë e formulës, për të rritur transparencën, këto fonde janë nxjerrë jashtë totalit të transfertës që ndahet me formulë. Duke filluar nga viti 2016, këto fonde paraqiten vetëm tek bashkitë përfituese si transfertë e pakushtëzuar, sikurse paraqitur në tabelën nr. 3 pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2021. Në totalin e transfertës së pakushtëzuar përfshihen edhe fondet për mirëmbajtjen e rrugëve rurale, që nga 2016 kanë kaluar nga këshillat e qarqeve tek bashkitë. Gjithashtu, fondet për këtë funksion nuk ndahen sipas formulës së transfertës së pakushtëzuar dhe paraqiten të veçanta për bashkitë përfituese në tabelën nr. 3 pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2021.

Në vitin 2021, në zbatim të nenit 28 dhe 37 të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", nenit 23 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", nenit 23 të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", vazhdon reforma e

sistemit të financimit të arsimit parashkollor duke e harmonizuar sistemin me praktikat më të mira ndërkombëtare në financimin e kopshteve. Kjo reformë pritet të sjellë një përmirësim të rëndësishëm në cilësinë e arsimit parashkollor në vendin tonë duke sjellë rritjen e numrit të edukatoreve. Kostoja e reformës është 327 milion lekë dhe do të vazhdojë të mbulohet nga transferta e pakushtëzuar e vitit 2021.

Pjesa Sektoriale e Transfertës së Pakushtëzuar përfshin financimin për funksionet e reja të transferuara në nivel vendor në vitin 2016 sipas ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore". Fondet për këto funksione nuk ndahen sipas formulës së ndarjes së transfertës së pakushtëzuar të përcaktuar në nenin 24 të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore". Fondet për këto funksione ndahen për çdo funksion dhe për çdo bashki, sipas kritereve specifike të përcaktuara në Aneksin nr. 4 dhe në kolonat e veçanta në tabelën nr. 3, pjesë përbërëse të ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2021.

Buxheti i vitit 2021, konfirmon vazhdimin e reformës në arsimin parashkollor. Duke filluar nga viti 2019, dhe në buxhetin e vitit 2021, fondet për arsimin parashkollor ndahen kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve me moshë 3-6 vjeç, si treguesi më i mirë i nevojës për shërbim dhe pjesërisht do të bazohet në sistemin aktual të ndarjes së fondeve sipas numrit të edukatoreve të transferuara në vitin 2016 deri në 2018. Më specifikisht, 60% e fondeve për pagat e edukatoreve ndahen mbi bazën e numrit të fëmijëve të regjistruar në kopshte dhe 40% mbi bazën e numrit të edukatoreve pranë këtyre kopshteve. Kjo reformë siguron një ndarje më të mirë të fondeve, duke u bazuar në numrin e fëmijëve që duhet t'u ofrohet edukimi parashkollor, por njëkohësisht siguron një tranzicion gradual që minimizon kostot, duke ruajtur 40% të kriterit të skemës së mëparshme. Reforma është plotësisht në përputhje me parashikimet e nenit 28 dhe 37 të ligjit nr. 69, datë datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar" dhe praktikat e mira ndërkombëtare që rekomandojnë një ndarje të fondeve, kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve. Ndryshimi i sistemit të ndarjes së fondeve për arsimin parashkollor në vendin tonë përbën një domosdoshmëri, pasi sistemi aktual nuk reflekton në mënyrë të saktë ndryshimet sociale, demografike dhe infrastrukturore që kanë ndodhur përgjatë më shumë se dy dekadave të fundit. Kjo domosdoshmëri njihet edhe nga legjislacioni aktual për arsimin parauniversitar në Shqipëri, i cili sugjeron një ndarje të fondeve, kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve.

Kjo reformë siguron:

-Uljen e madhësisë mesatare të grupeve/klasave të fëmijëve në kopshte nga raporti mesatar 18 fëmijë për një eduktore (para reformës) në raportin 15 fëmijë për një edukatore.

-Shtimin e fondeve në ato bashki ku ka një nevojë reale për shtimin e numrit të edukatoreve duke ulur madhësinë maksimale të grupeve nga 26 apo 25 fëmijë për një edukatore (para reformës) në 18 fëmijë për edukatore, një parakusht për përmirësimin e cilësisë së edukimit për fëmijët nga 3-6 vjeç që ndjekin kopshtet publike. Shtimi i numrit të edukatoreve nënkupton edhe shtimin e kapaciteteve të shërbimit, duke ulur kështu nevojën për dërgimin e fëmijëve në kopshte private.

-Ruajtjen e fondeve aktuale për ato bashki të cilat rezultojnë të kenë një numër relativisht "të lartë" edukatorësh për numrin e fëmijëve të regjistruar në kopshte, krahasimisht me bashkitë e tjera.

-Një ndarje më të drejtë të fondeve për pagat e edukatoreve, duke zbutur diferencat ndërmjet bashkive përsa i përket raportit fëmijë për edukatore.

-Shtim fondi për stafin mbështetës të arsimit parashkollor.

Kjo reformë, bën një ndarje më të drejtë të fondeve ndërmjet bashkive, zbut diferencat ndërmjet bashkive përsa i përket raportit "fëmijë për edukatore" dhe siguron fonde shtesë për ato bashki që kanë një nevojë imediate për rritjen e numrit të edukatorëve.

Gjithashtu për vitin 2021, fondi prej 500 milion lekë për funksionin e "Mbrojtjes civile" është transfertë specifike. Ky fond është shpërndarë me një formulë e cila bazohet në peshën specifike që zë buxheti i çdo bashkie për vitin 2019 ndaj totalit të buxhetit të të gjitha bashkive. Pjesën tjetër të fondit bashkitë mund ta sigurojnë nëpërmjet përdorimit të fondit rezervë dhe të kontigjencës ose/dhe pjesë nga buxhetet e tyre (transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore).

Në buxhetin e vitit 2021, do të ndahen me formulën e rishikuar të transfertës së pakushtëzuar 21,202,280,548 lekë, e cila përfshin edhe 3,712,238,000 lekë për personelin mësimor në arsimin parashkollor dhe 500,000,000 lekë për mbrotjen civile (pjesë e transfertës së pakushtëzuar sektoriale). Fondet e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të reja të transferuara në vitin 2016, paraqiten në tabelën nr. 3, pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2021.

3. Ndarja e Transfertës së Pakushtëzuar ndërmjet dy niveleve të Qeverisjes Vendore

Për vitin 2021, për financimin e funksioneve të veta Bashkitë marrin 97.4% të totalit të transfertës së pakushtëzuar së parashikuar për t'u ndarë me formulë, ose 20,652,280,548 lekë. Funksionet e reja të transferuara te bashkitë në vitin 2016, financohen nëpërmjet transfertave të pakushtëzuara sektoriale me kolona të veçanta në tabelën nr.3 pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2021. Fondet për arsimin parashkollor në këtë buxhet janë shpërndarë sipas një formule e cila mbështetet kryesisht në numrin e fëmijëve me moshë 3-6 vjeç. Po ashtu fondet për mbrojtjen civile janë shpërndarë me një formulë e cila bazohet në peshën specifike që zë buxheti i çdo bashkie ndaj totalit të buxhetit të të gjitha bashkive.

Ndarja e Transfertës së Pakushtëzuar ndërmjet dy niveleve të Qeverisjes	Në përqindje	Vlera në lekë
Transferta e Pakushtëzuar për Bashkitë	**97.4%**	**20,652,280,548**
Transferta e Pakushtëzuar për Qarqet	**2.6%**	**550,000,000**

Për vitin 2021, Qarqet marrin **2.6 %** të transfertës së pakushtëzuar ose **550 milion lekë**. Në vijim të transferimit të funksionit të rrugëve rurale nga qarqet tek bashkitë, fondet e shpenzuara nga qarqet për këtë funksion i transferohen bashkive sipas tabelës nr. 3, pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2021.

4. Koeficienti i përshtatjes së të dhënave të popullsisë

Popullsia është një tregues i lidhur ngushtë me shpenzimet dhe nevojat për shërbime. Për rrjedhojë popullsia do të vazhdojë të mbetet kriteri kryesor për ndarjen e transfertës së pakushtëzuar ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore.

Koeficienti i përshtatjes së të dhënave të popullsisë		30%
Banorë rezidentë efektivë = [CENSUS + (Regjistri i gjendjes civile – Census)*30%]		**3,319,124**

Të dhënat për popullsinë që përdoren në aplikimin e formulës bazohen kryesisht në të dhënat e Censusit të vitit 2011. Këtyre të dhënave u shtohet 30% e diferencës midis të dhënave të Censusit dhe Gjendjes Civile (të vitit 2020) për secilën njësi të vetëqeverisjes vendore. Kështu, nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore sipas Censusit të vitit 2011 ka 30,000 banorë, ndërsa sipas Regjistrit të Gjendjes Civile rezulton të ketë 45,000 banorë, atëherë, numri i popullsisë së përdorur për alokimin e fondeve për këtë bashki do të jetë 30,000 + [(45,000-30,000)*30%] = 34,500 banorë të konsideruar rezidentë efektivë në atë njësi të vetëqeverisjes vendore. Në këtë mënyrë, popullsia rezidente rezulton rreth 3.3 milion banorë, nga 2.8 milion që raportohet nga Censusi dhe 4.5 milion që raportohet nga Regjistri i Gjendjes Civile. Vlerësohet se një kompromis midis dy burimeve të të dhënave është i nevojshëm dhe rregullimi me 30% të diferencës midis të dhënave të Gjendjes Civile dhe Censusit amortizon ndryshimet në transfertë që do të pësonte një njësi nga kalimi nga një formulë në tjetrën.

5. Shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar për Bashkitë

Për vitin 2021, transferta e pakushtëzuar e cila ndahet sipas formulës për 61 bashkitë është 20,652,280,548 lekë dhe do të ndahet sipas kritereve të mëposhtme. Kriteret e shpërndarjes së fondeve në formulë kërkojnë të identifikojnë nevojat reale të shpenzimeve të njësive të ndryshme të vetëqeverisjes vendore mbi bazën e popullsisë, dendësisë së popullsisë dhe numrit të fëmijëve në kopshte dhe nxënësve në shkollat publike 9-vjeçare dhe të mesme në territorin e një bashkie.

Në formulë, 62.42% e transfertës për bashkitë alokohet mbi bazën e popullsisë relative. Në vijim të rregullimit të numrit të popullsisë së Censusit duke i shtuar atij edhe 30% të diferencës midis të dhënave të Gjendjes Civile dhe të dhënave të Censusit, çdo njësi e vetëqeverisjes vendore merr një transfertë të pakushtëzuar prej 3,884 lekë, për çdo banor rezident në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

Përbërja e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë	**20,652,280,548**
Komponenti I: Ndarja sipas popullsisë (në përqindje)	**62.42%**
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas numrit të banorëve rezidentë efektivë	**12,890,434,038**
Transferta e pakushtëzuar për frymë	**3,884**

Dendësia e popullsisë është një kriter tjetër që përdoret për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë. Dendësia e popullsisë më e ulët është në bashkitë që përbëhen kryesisht ose plotësisht nga zona rurale dhe/ose malore. Ka një korrelacion të fortë mes njësive të vetëqeverisjes vendore me dendësi të ulët dhe atyre sipërfaqja e të cilave është mbi 50% malore. Kështu koeficienti, "dendësi e ulët e popullsisë", çon fonde shtesë në të njëjtin drejtim siç bënte formula e mëparshme e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar, nëpërmjet përdorimit të koeficientëve shtesë për njësitë vendore malore dhe në vështirësi financiare.

Në formulë 11.7 % e totalit të fondit për bashkitë, ndahet mbi bazën e dendësisë së popullsisë, e cila ndahet në kufij sipas tabelës së mëposhtme.

Komponenti II: Ndarja sipas dendësisë së popullsisë (në përqindje)							**11.7%**
Madhësia e Transfertës së Pakushtëzuar që shpërndahet sipas dendësisë së popullsisë							**2,416,956,383**
Mesatarja Kombëtare e Dendësisë së Popullsisë							117 banorë/km^2
Transferta për frymë nga densiteti i popullsisë							2,110 lek/banorë
Kufijtë e dëndësisë së popullsisë si % ndaj mesatares kombëtare		**Koefiçentëte rregullimit**	Numri i NJVV-ve përfituese	Dëndësia e popullsisë korrespondue se	Popullsia në çdo grup	Popullsia e korrektuar me koeficentin e rregullimit për çdo grup	Shuma e fondeve shtesë për çdo grup
Kufiri 1	**22%**	**2.270**	10	25.1	115,512	262,212	553,160,741
Kufiri 2	**43%**	**1.669**	13	50.3	280,073	467,441	986,109,967
Kufiri 3	**75%**	**0.900**	10	87.7	348,198	313,378	661,100,590
Kufiri 4	**110%**	**0.350**	6	128.7	286,795	100,378	211,757,188
Kufiri 5	**>110%**	**0.001**	22	>130.1	2,288,546	2,289	4,827,897
Totali			61		3,319,124	1,145,698	2,416,956,383

Një njësi e vetëqeverisjes vendore me një sipërfaqe të madhe dhe një popullsi më të ulët, nënkupton, për të gjitha kushtet e tjera të barabarta, të ketë kosto më të larta të ofrimit të shërbimeve, rrugë më të gjata dhe shpenzime të tjera infrastrukturore që kushtojnë. Për të kompensuar njësitë me dendësi më të ulët për kostot më të larta të shërbimit janë krijuar 5 grupime të njësive të vetëqeverisjes vendore sipas ngjashmërisë më të madhe të dendësisë. Njësitë me dendësi më të ulët popullsie përfitojnë nga koeficientë shtesë më të lartë se ato njësi të cilat kanë një afërsi më të madhe të dendësisë me mesataren kombëtare. Nga ky kriter përfitojnë të gjitha bashkitë, në të cilat banojnë 3,319,124 banorë rezidentë efektivë. Nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore ka një dendësi mesatare nën 22% të mesatares kombëtare, ose mesatarisht 26 banorë për km^2, atëherë popullsia e saj relative do të shumëzohet me 2.270. Nëse ka një dendësi midis 22% dhe 44% të mesatares kombëtare, atëherë popullsia e saj relative do të shumëzohet me një koeficient prej 1.669. Pra duke u afruar mesatares kombëtare, koeficientët vijnë duke u zvogëluar. Në përfundim numri i popullsisë për çdo grup dendësie, shumëzohet me koeficientin përkatës dhe transfertën për frymë prej **2,110 lekë** për banorë (që rezulton nga pjesëtimi i

shumës prej **2,416,956,383 lekë** me popullsinë totale që rezulton nga aplikimi i koeficientëve për çdo grup).

Kriteri i tretë mbi të cilin ndahet transferta e pakushtëzuar për bashkitë është numri i fëmijëve në arsimin parashkollor i kombinuar me numrin e personelit mësimor në arsimin parashkollor, dhe numri i nxënësve në shkollat publike nëntë-vjeçare dhe të mesme. Nga viti 2019, dhe në vazhdim formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar përditësohet për të akomoduar përfshirjen dhe ndarjen e fondeve për pagat e personelit mësimor në sistemin arsimor parashkollor. Në këtë kuadër, komponenti i arsimit i formulës së transfertës së pakushtëzuar do të ndajë gjithsej 23.46% e totalit të transfertës për tu ndarë me formulë, ose 4,844,890,127 lekë. Nga kjo shumë, 4,039,238,000 lekë janë të dedikuara për pagat e personelit mësimor në arsimin parashkollor. Fondet ndahen 60% mbi bazën e numrit të fëmijëve të regjistruar në kopshte dhe 40% mbi bazën e numrit të edukatoreve pranë këtyre kopshteve. Në krahasim me vitin 2018 (si vit i fundit i skemës së vjetër), fondet për pagat e personelit mësimor të arsimit parashkollor janë 430 milion lekë ose 10% më të larta.

Ndërkohë, pjesa prej 5% e totalit të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme për bashkitë, ose 805,652,127 lekë do të ndahet mbi numrin faktik të nxënësve në shkollat publike në çdo bashki, kundrejt totalit kombëtar të nxënësve. Bashkitë do të marrin një fond prej 1,917 lekë për çdo nxënës në territorin e tyre.

Komponenti III: Ndarja sipas numrit të fëmijëve dhe nxënësve (në %)	23.46%
Transferta e pakushtëzuar sipas numrit të fëmijëve dhe nxënësve, në lek	**4,844,890,127**
Vlera për personelin mësimor në arsimin parashkollor, në lek	4,039,238,000
Sipas numrit të nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme	805,652,127

Kriter tjetër për ndarjen e transfertës së pakushtëzuar sektoriale për mbrotjen civile është përdorur pesha specifike e buxhetit të çdo bashkie ndaj totalit të buxhetit faktit të të gjitha bashkive për vitin 2019.

Komponenti IV: Ndarja sipas peshës së buxhetit faktik 2019 (në %)	2.42%
Transfertë specifike për mbrotjejn civile sipas peshës së buxhetit të çdo bashkie ndaj totalit të buxhetit të të gjitha bashkive, në lek	
Sipas peshës së buxhetit të vitit 2019	500,000,000

6. Ekualizimi i transfertës së pakushtëzuar mbi bazën e të ardhurave nga taksat e ndara dhe në raport me transfertën e vitit të mëparshëm

Për të siguruar një ekualizim horizontal efektiv të transfertës së pakushtëzuar ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore në mënyrë që të merren në konsideratë kapacitetet e ndryshme fiskale ndërmjet tyre, në formulë llogaritjet bazohen mbi të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore, të cilat mblidhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatim i thjeshtuar i fitimit mbi biznesin e vogël, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të pasurisë për pasuritë e paluajtshme të shitura nga personat juridikë të cilat mblidhen nga agjenci qendrore dhe u transferohen njësive të vetëqeverisjes vendore. Në këtë mënyrë njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurohen që të ardhurat që ata mbledhin vetë nuk preken nga sistemi i ekualizimit duke evituar kështu çdo lloj disincentivimi në mbledhjen e taksave. Në vitin 2019, pjesa e të ardhurave nga këto taksa që u janë transferuar njësive të vetëqeverisjes vendore është 2,438,580,554 lekë, dhe të ardhurat kombëtare për frymë (TAKPF), ose mesatarja kombëtare për frymë rezulton 735 lekë për banor, sipas konceptit "banor rezident efektiv".

Komponenti IV: Sistemi i Ekualizimit të të ardhurave						
Të ardhurat nga taksat e ndara që do të përdoren për ekualizimin e të ardhurave (Biznesi i Vogël + Taksa e Automjeteve + Taksa mbi transferimin e pasurisë nga personat juridik)						**2,438,580,554**
Të ardhurat kombëtare për frymë (TAKPF), Të ardhura për frymë (TAPF)						**735**
Nëse NJVV-të kanë TAPF nën	**80%**	të TAKPF, atëherë ato kompensohen me	**100%**	të diferencës	Madhësia e ekualizimit fiskal (fondet që duhet të shtohen)	**384,670,257**
duke u marrë NJVV-ve me të ardhura për frymë mbi	**120%**	të mesatares kombëtare (TAKPF)	**50%**	të difirencës	Fondet që efektivisht shkurtohen	**326,594,820**
Koeficienti i rishpërndarjes						**0.85**

Njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë të ardhura për frymë (TAPF) nën 80% të mesatares kombëtare (TAKPF) prej 735 lekë/frymë, do të kompensohen me 100% të diferencës ndërmjet të ardhurave të tyre për frymë dhe mesatares kombëtare. Kjo llogaritje tregon sa fonde do duhej t'u shtoheshin njësive me të ardhura më të ulta për ti sjellë ato në nivelin prej 588 lekë/frymë (ku 735*80%=588 lekë). Për të sjellë të gjitha bashkitë me të ardhura më "të ulta" në nivelin prej 80% të mesatares kombëtare, njësive me të ardhura më të larta se 120% e mesatares kombëtare, (pra me TAPF mbi 882 lekë/frymë) do t'u merret 50% e diferencës midis të ardhurave të tyre për frymë dhe 120% të mesatares kombëtare. P.sh., nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore ka të ardhura për fryme prej 1200 lekë/frymë, sipas formulës së mësipërme asaj do ti zbriten 159 lekë/frymë {[(1200 – (120%*735))*50% = 159 lekë/banor]}. Kjo llogaritje në fund tregon sa janë fondet realisht të disponueshme të cilat mund të transferohen nga njësitë me të ardhura më të larta tek ato më të ultat. Sistemi balancohet automatikisht nëpërmjet një koeficienti të rishpërndarjes i cili përcaktohet nga raporti midis fondeve disponibël për ekualizim dhe fondeve të nevojshme për ekualizim. Për vitin 2021, fondet e nevojshme për ekualizim janë 384,670,257 lekë, ndërkohë që fondet e disponueshme për ekualizim që vijnë nga "taksimi" prej 50% të të ardhurave mbi 735 lekë/frymë i njësive me të ardhura më të larta janë 326,594,820 lekë dhe për rrjedhojë koeficienti i rishpërndarjes është 0.85.

7. Shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar për Qarqet

Qarqeve do t'u ndahen 550 milion lekë, sipas një shume fikse, të barabartë për secilin nga 12 Qarqet, sipas popullsisë rezidente dhe sipas dendësisë së popullsisë në çdo qark kundrejt mesatares kombëtare. Sipas kriterit të parë, 20% e totalit të transfertës së pakushtëzuar të qarqeve (ose 110 milionë lekë) do të shpërndahet si një shumë fikse prej rreth 9.2 milion lekë për secilin nga 12 Qarqet.

Përbërja e transfertës së pakushtëzuar për qarqet	**550,000,000**
Komponenti I: Shuma fikse për qarqet (në përqindje)	**20%**
Transferta e pakushtëzuar për t'u ndarë sipas shumës fikse	110,000,000
Shuma fikse e transfertës së pakushtëzuar për çdo qark	9,166,667

Sipas kriterit të dytë, 50% e transfertës së pakushtëzuar (ose 275 milion lekë) do të ndahet përpjesëtimisht sipas popullsisë rezidente në çdo qark, kundrejt popullsisë totale. Të dhënat për popullsinë e qarqeve ndjekin të njëjtin rregullim të bërë për popullsinë e bashkive.

Komponenti II: Ndarja sipas banorëve rezidentë efektivë (në përqindje)	**50%**
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas numrit të banorëve rezidentë efektivë	275,000,000
Transferta e pakushtëzuar për frymë (Banorë rezidentë efektivë)	83

Sipas kriterit të tretë, 30% e transfertës së pakushtëzuar (ose 165 milion lekë) do të ndahen mbi bazën e dendësisë së popullsisë në çdo qark, kundrejt dendësisë mesatare kombëtare.

Komponenti III: Ndarja sipas dendësisë së popullsisë (në përqindje)							30%
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas dendësisë së popullsisë							165,000,000
Mesatarja kombëtare e dendësisë së popullsisë							117 banorë/km²
Transferta për frymë nga komponenti i dendësisë së popullsisë							208 lek/banorë
Kufijtë e dendësisë së popullsisë si % ndaj mesatares kombëtare		Koeficientët	Numri i Qarqeve që përfitojnë	Dendësia e popullsisë për grup	Popullsia për çdo grup	Shuma e shtuar për secilin grup	% e shpërndarjes për grup
Kufiri 1	**90%**	**0,3**	4	105.3	918,119	56,905,335	34%
Kufiri 2	**65%**	**0,5**	3	76.0	668,919	68,963,125	42%
Kufiri 3	**35%**	**1,0**	2	40.9	190,458	39,131,540	24%
Totali			9		1,777,496	165,000,000	

Qarqet me dendësi më të ulët të popullsisë, duke prezumuar kosto më të larta për ofrimin e shërbimeve dhe/ose kapacitet fiskal më të ulët, do të përfitojnë fonde shtesë nëpërmjet koeficientëve të përcaktuar më sipër për secilin nga tre grupet. Qarqet janë ndarë në tre grupe të ndryshëm sipas raportit mes dendësisë së tyre të popullsisë dhe mesatares kombëtare. Kufijtë e ndarjes së grupeve ndjekin ngjashmërinë e raportit të dendësisë ndaj mesatares kombëtare. Kështu, nëse një Qark ka një dendësi të popullsisë nën 35% të mesatares kombëtare, që nënkupton mesatarisht më pak se 41 banorë për km², kundrejt mesatares kombëtare prej 117 banorë për km², dhe një popullsi prej 93,225 banorësh rezidentë, atëherë popullsia e atij qarku shumëzohet me koeficientin shtesë përkatës (+1) dhe transfertën për frymë prej 208 lekë për banor, duke rezultuar në një shtesë fondesh prej 19,390,800 lekë (i llogaritur në këtë mënyrë: 93,225*1*208).

ANEKS 2
Kriteret e Shpërndarjes së Fondit Rezervë

Nivelet e Pushtetit Vendor	Kriteret
A. Për bashkitë	Kompensim për ndonjë gabim në përllogaritjen e kritereve të formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2021. Për funksionet e reja të transferuara në bashkitë që nga viti 2016. Për shpenzime të shërbimeve të shkaktuara nga Covid-19 Për nevoja të ndryshme financiare të bashkive.
B. Për qarqet	Për shpenzime të ndryshme që mund të nevojiten gjatë vitit.

Shuma që akordohet nga fondi rezervë për njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk duhet të kaloj 50 për qind të nivelit të transfertës së pakushtëzuar të akorduar me ligjin e buxhetit të vitit 2021.

Pjesa e papërdorur e fondit rezervë në vitin buxhetor 2021, kalon në transfertën e pakushtëzuar të vitit 2022.

Procedurat për alokimin e këtij fondi përcaktohen në udhëzimin plotësues të zbatimit të buxhetit të vitit 2021.

ANEKSI 3
Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe Programi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale

1. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor.

2. Për vitin 2021, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga granti konkurrues për arsimin.

3. Shpërndarja e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve sipas projekteve kryhet nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, i cili kryesohet nga Kryeministri dhe ka këtë përbërje:

1. Kryeministrin	Kryetar
2. Zëvendëskryeministrin	Zëvendëskryetar;
3. Ministrin e Financave dhe Ekonomisë	anëtar;
4. Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	anëtar;
5. Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	anëtar;
6. Ministrin e Kulturës	anëtar;
7. Ministrin e Brendshëm	anëtar;
8. Kryetarin e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
9. Kryetarin e Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar;
10. Kryetarin e Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;

Në mungesë të kryetarit të Komitetit, mbledhja drejtohet nga zëvendëskryetari.

4. Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve miraton:

a) Specifikimet, rregullat dhe kriteret për financimin e projekteve dhe ndarjen e grantit të arsimit;

b) Shpërndarjen e fondeve për financim për projekte të reja investimi;

5. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në përputhje me ecurinë e projektit. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë mund të kërkojë rialokime midis projekteve të FZHR-së, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.

6. Thirrjet për aplikim në Fondin e Zhvillimit të Rajoneve për vitin buxhetor mund të bëhen që në Nëntor të vitit paraardhës.

7. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve nuk trashëgohet në vitin e ardhshëm, buxhetor.

8. Sekretariati teknik për grantin për arsimin ngrihet pranë Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve është një njësi pranë Kryeministrisë.

9. Subjektet aplikuese dhe zbatuese janë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Komiteti miraton me vendim autoritetin kontraktor për zbatimin e projektit. Rregulla të hollësishme lidhur me raportimin e autoriteteve kontraktuese miratohen me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Programi buxhetor për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale në Fondin Shqiptar të Zhvillimit

1. Fondet për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, të parashikuara si program buxhetor në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, janë një mekanizëm financiar që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor. Autoriteti programues, kontraktues dhe zbatues është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

2. Specifikimet, rregullat, kriteret për financimin e projekteve si dhe shpërndarja e Fondit për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale për financimim e projekteve të reja miratohen nga Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

3. Fondi Shqiptar i Zhvillimit administron nevojat dhe propozimet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, qendrore dhe aktorë të tjerë (përfshirë FSHZH dhe njësitë e zhvillimit rajonal të tij) që konsistojnë në projekte në interes dhe në funksion të zhvillimit lokal e rajonal, përfshirë edhe projekte zhvillimore me natyrë ekonomike, të zbatuara në partneritet midis FSHZH dhe njësive të vetëqeverisjes vendore dhe subjekte të tjera.

4. Nga fondi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces me burim financimi ish-Fondin e Zhvillimit të Rajoneve-Infrastrukura Vendore dhe Rajonale. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të FSHZH-së, në përputhje me ecurinë e projektit. Fondi Shqiptar i Zhvillimit mund të kërkojë rialokime midis projekteve, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.

5. Rregulla të hollësishme lidhur me funksionimin e të gjithë procesit të programimit,

monitorimit dhe raportimit të ecurisë së zbatimit miratohen me vendim të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar

ANEKS 4
Për funksionet e transferuara në njësitë e vetëqeverisjes vendore

1. Konviktet e arsimit parauniversitar

Në transfertën e vitit 2021, disa bashkive i janë akorduar fondet për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë përfshihen fondet për shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), për shpenzimet operative dhe për shpenzimet për investime.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre konvikteve, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të mbështeten në kuadrin rregullator që ka përdorur Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

2. Qëndrat e Shërbimeve Sociale

Në transfertën e vitit 2021 të bashkive, Berat, Elbasan, Shkodër, Vau i Dejës, Fier, Kuçovë dhe Kukës i janë akorduar fondet për paga dhe sigurime shoqërore për personelin shërbyes dhe shpenzime operative për qendrat, "Lira", Berat, "Balash", Elbasan, "Shpresa" Shkodër, "Opera Della Madonnina Della Grappa", Shkodër, "Besa" Vau i Dejës, "Horizont", Fier dhe qendrat ditore të fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për bashkitë Kuçovë dhe Kukës.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre qendrave bashkitë Berat, Elbasan, Shkodër, Vau i Dejës, Fier, Kuçovë, dhe Kukës do të mbështeten në kuadrin rregullator që përdor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këto qëndra.

3. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MZSH)

Në transfertën e vitit 2021, të bashkive është akorduar fondi për funksionin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Ministria e Brendshme duhet t'ju dërgojë bashkive kuadrin ligjor dhe të dhëna të tjera që disponon të cilat janë të lidhura me shërbimin. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

4. Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar

Në transfertën e vitit 2021, njësive të vetëqeverisjes vendore i janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniveristar. Në fondet e personelit ndihmës të arsimit parauniversitar nuk përfshihet arsimi i mesëm profesional.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

5. Rrugët rurale

Në transfertën e vitit 2021, njësive të vetëqeverisjes vendore i është akorduar fondi për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në rrugët rurale.

6. Administrimi i pyjeve

Në transfertën e vitit 2021, njësive të vetëqeverisjes vendore i është akorduar fondi për Shërbimin Pyjor. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

7. Ujitja dhe Kullimi

Në transfertën e vitit 2021, njësive të vetëqeverisjes vendore i është akorduar fondi për ujitjen dhe kullimin. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e

vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

8. Klubet sportive shumësportëshe , "Partizani" dhe "Studenti"

Në transfertën e vitit 2021, bashkisë Tiranë i janë akorduar fondet për shpenzime për personelin dhe për shpenzime operative për klubet sportive shumësportëshe "Partizani" dhe "Studenti". Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Bashkia Tiranë mund të shtojë fonde nga të ardhurat e veta për të rritur cilësinë e shërbimit në këto klube.

9. Mbrojtja Civile

Në transfertën e vitit 2021, bashkive u është akorduar një fond prej 500 milion lekë si transfertë specifike për mbrojtjen civile. Ky fond është shpërndarë me një formulë e cila bazohet në peshën specifike që zë buxheti i çdo bashkie ndaj totalit të buxhetit të të gjitha bashkive. Pjesën tjetër të fondit bashkitë mund ta sigurojnë nëpërmjet përdorimit të fondit rezervë dhe të kontigjencës ose/dhe pjesë nga buxhetet e tyre (transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore).

Fondi prej 500 milion lekë si transfertë specifike do të përdoret vetëm për rastet e emergjencave civile dhe është i trashëgueshëm në vitin tjetër me këtë destinacion. Mënyra dhe kriteret e përdorimit të kësaj transferte specifike për mbrojtjen civile propozohen nga Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave brënda tremujorit të parë të vitit 2021.

Ministria e Mbrojtjes, duhet t'ju dërgojë bashkive kuadrin ligjor dhe të dhëna të tjera që disponon të cilat janë të lidhura me mbrojtjen civile. Standardet dhe kriteret e ofrimit të këtij shërbimi do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

VENDIM
Nr. 76/2020

PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 11 866, DATË 11.12.2020, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS "PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 137/2020 "PËR BUXHETIN E VITIT 2021""

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 11 866, datë 11.12.2020, të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr.137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021"".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 17.12.2020

VENDIM
Nr. 77/2020

PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT ALTIN BINAJ ANËTAR I GJYKATËS KUSHTETUESE

Në mbështetje të nenit 125, pika 2, nenit 127, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 7/c të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Altin Binaj zgjidhet anëtar i Gjykatës Kushtetuese.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 17.12.2020

VENDIM
Nr. 78/2020

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIMIN E MINISTRIT TË BRENDSHËM

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës dhe të dekretit nr.11 873, datë 17.12.2020, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11 873, datë 17.12.2020, për shkarkimin e zotit Sandër Lleshaj nga detyra e ministrit të Brendshëm.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 17.12.2020

VENDIM
Nr. 79/2020

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIMIN E MINISTRIT TË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës dhe të dekretit nr.11 874, datë 17.12.2020, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11 874, datë 17.12.2020, për shkarkimin e zotit Bledar Çuçi nga detyra e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 17.12.2020

VENDIM
Nr. 80/2020

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E MINISTRIT TË BRENDSHËM

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës dhe dekretit nr. 11 875, datë 17.12.2020, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11 875, datë 17.12.2020, për emërimin e zotit Bledar Çuçi në detyrën e ministrit të Brendshëm.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 17.12.2020

VENDIM
Nr. 81/2020

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E MINISTRIT TË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës dhe dekretit nr. 11 876, datë 17.12.2020, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I.Miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11 876, datë 17.12.2020, për emërimin e zonjës Milva Ekonomi në detyrën e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 17.12.2020

AKT NORMATIV
Nr. 34, datë 16.12.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.88/2019, "PËR BUXHETIN E VITIT 2020", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Nenet 2, 3, 4, 5 dhe 6, ndryshohen, si më poshtë vijon:

"Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2020 është:

Të ardhurat	326 525 milionë lekë
Shpenzimet	459 490 milionë lekë;
Deficit	132 965 milionë lekë.

Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2020 është:

Të ardhurat	53 285 milionë lekë;
Nga të cilat:	
- transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	18 270 milionë lekë;
- transferta e pakushtëzuar sektoriale	7 840 milionë lekë:
- Të ardhura të tjera	27 175 milionë lekë;
Shpenzimet	53 285 milionë lekë.

Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2020 është:

l. Sigurimi i detyrueshëm, programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta.

Të ardhurat, gjithsej	134 230 milionë lekë;
Nga të cilat:	
- kontributet	81 040 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	47 790 milionë lekë;
- transferta nga buxheti për indeksimin e pensioneve	2 000 milionë lekë;
-transferta nga buxheti për bonusin e pensionistëve	3 400 milionë lekë;
Shpenzimet	134 230 milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe të kategorive të veçanta të personave të vetëpunësuar. Për vitin 2020, teprica ndërmjet të

ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve dhe programeve të sigurimit shoqëror të detyrueshëm e suplementar, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Sigurimi suplementar

Të ardhurat, gjithsej	6 538 milionë lekë;
Nga të cilat:	
- kontributet	1 500 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	4 938 milionë lekë;
- transferta për indeksimin e pensioneve	100 milionë lekë;
Shpenzimet	6 538 milionë lekë.

Fondi për indeksimin e pensioneve është parashikuar 2 100 milionë lekë. Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2 650 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta. Kriteret, masa dhe rregullat për përdorimin e bonusit të pensionistëve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Instituti i Sigurimeve Shoqërore autorizohet të përdorë gjendjen në llogarinë bankare mbi fondin rezervë, përpara përdorimit të transfertës së buxhetit të shtetit, gjithmonë duke ruajtur tavanin e shpenzimeve të përcaktuar më sipër. Në rast se nevojitet, ministria përgjegjëse për financat autorizon përdorimin e fondit rezervë të ISSH-së.

Neni 5

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2020 është:

Të ardhurat, gjithsej	45 704 milionë lekë;
Nga të cilat:	
- kontributet dhe të tjera	13 460 milionë lekë
- transferimet nga buxheti i shtetit	32 244 milionë lekë;
Shpenzimet	45 704 milionë lekë

Fondi për rimbursimin e medikamenteve nuk tejkalon tavanin prej 11 150 milionë lekësh, përfshirë edhe detyrimet e prapambetura. Fondi për shërbimin spitalor, si dhe fondi për shpenzimet Anti-COVID prej 2 500 milionë lekësh përdoret për gjithë sistemin shëndetësor me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Buxheti i fondit për kompensimin në vlerë të pronarëve për vitin 2020 është:

Të ardhurat, gjithsej	2 900 milionë lekë;
Nga të cilat:	
- të ardhura të tjera	1 000 milionë lekë
- transferimet nga buxheti i shtetit	1 900 milionë lekë;
Shpenzimet	2 900 milionë lekë.".

Neni 2

Neni 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 9

Të ardhurat e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Grantet	16 000 milionë lekë
Të ardhurat tatimore	290 000 milionë lekë;
Të ardhurat jotatimore	20 525 milionë lekë.".

Neni 3

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

a) Në paragrafin e tretë, shuma 15 184 milionë lekë bëhet 17 184 milionë lekë.

b) Shifra 49 833 milionë lekë bëhet 47 833 milionë lekë.

Neni 4

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Shpenzime të buxhetit qendror	439 190 milionë lekë;
Fondi rezervë	2 700 milionë lekë;
Kontingjencë për risqet e borxhit	4 100 milionë lekë
Kontigjencë për paketën Anti-COVID19	13 500 milionë lekë.".

b) Tabelat 1 dhe 4 zëvendësohen me tabelat me të njëjtin numër.

c) Fondi prej 200 milionë lekësh nga shpenzimet kapitale transferohet në llogarinë e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë dhe përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Tabela 3, që përmendet në nenin 15, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij akti normativ dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 6

Ngarkohet ministri i Financave dhe Ekonomisë për nxjerrjen e udhëzimeve për zbatimin e këtij akti normativ.

Neni 7

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

AKTI NORMATIV NR.34_2020 SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

Tab.1

Kodi	Emertimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Financim i Brendshem	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
1	**Presidenca**	**229,300**	**6,000**	**0**	**6,000**	**235,300**
01120	Veprimtaria e Presidentit	229,300	6,000	0	6,000	235,300
2	**Kuvendi**	**1,031,160**	**198,000**	**0**	**198,000**	**1,229,160**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	399,425	198,000	0	198,000	597,425
01120	Veprimtaria Ligjvenese	631,735	0	0	0	631,735
3	**Kryeministria**	**442,000**	**99,000**	**100,000**	**199,000**	**641,000**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	442,000	99,000	100,000	199,000	641,000
5	**Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural**	**4,128,900**	**2,945,485**	**3,511,163**	**6,456,648**	**10,585,548**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	305,200	3,660	0	3,660	308,860
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,093,500	118,429	319,918	438,347	1,531,847
04240	Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes	649,000	2,066,000	1,615,800	3,681,800	4,330,800
04250	Zhvillimi Rural duke mbesht. Prodh. Bujq, Blek, Agroind dhe Market.	1,500,000	607,965	1,575,445	2,183,410	3,683,410
04860	Keshillimi dhe Informacioni Bujqesor	459,000	14,500	0	14,500	473,500
05470	Menaxhimi qendrueshem i tokes bujqesore	12,200	0	0	0	12,200
04230	Mbeshtetje per Peshkimin	110,000	134,931	0	134,931	244,931
6	**Ministria e Infrastruktures dhe Energjise**	**4,602,915**	**31,963,114**	**13,063,680**	**45,026,794**	**49,629,709**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	501,356	2,600	0	2,600	503,956
04520	Transporti rrugor	1,499,500	20,644,742	6,503,132	27,147,874	28,647,374
04540	Transporti Detar	108,009	35,000	2,000	37,000	145,009
04550	Transporti Hekurudhor	423,700	85,700	250,000	335,700	759,400
04560	Transporti Ajror	20,200	35,000	0	35,000	55,200
06370	Furnizimi me Uje dhe Kanalizime	793,500	8,569,800	3,435,548	12,005,348	12,798,848
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	700,000	2,144,272	630,000	2,774,272	3,474,272
04320	Mbeshtetje per Energjine	87,900	168,000	2,120,000	2,288,000	2,375,900
04430	Mbeshtetje per Burimet Natyrore	147,000	115,000	0	115,000	262,000
04440	Mbeshtetje per Industrine	290,650	85,000	0	85,000	375,650
06180	Planifikimi Urban	31,100	78,000	123,000	201,000	232,100
10	**Ministria e Financave dhe Ekonomise**	**66,026,200**	**2,044,602**	**1,203,000**	**3,247,602**	**69,273,802**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	638,500	250,000	531,000	781,000	1,419,500
01120	Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	416,000	0	0	0	416,000
01130	Ekzekutimi i Pagesave te Ndryshme	400,000	200,000	0	200,000	600,000
01140	Menaxhimi i te Ardhurave Tatimore	2,657,000	417,000	4,000	421,000	3,078,000
01150	Menaxhimi i te Ardhurave Doganore	2,875,000	147,220	84,100	231,320	3,106,320
01160	Lufta kunder Transaksioneve Financiare Jo-Ligjore	78,900	2,000	0	2,000	80,900
04130	Mbeshtetje per Zhvillim Ekonomik	263,500	22,760	225,000	247,760	511,260
04160	Mbeshtetje per Mbikq. e Tregut, Infrast. e Ciles. dhe Pron. Industr.	290,500	11,000	0	11,000	301,500
10220	Sigurimi Shoqeror	51,070,150	0	0	0	51,070,150
10550	Tregu i Punes	2,042,500	40,800	0	40,800	2,083,300
04170	Inspektimi ne Pune	165,300	1,300	0	1,300	166,600
09240	Arsimi i Mesem (profesional)	1,941,500	597,559	358,900	956,459	2,897,959
06190	Strehimi	3,187,350	354,963	0	354,963	3,542,313
11	**Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise**	**38,047,763**	**2,415,359**	**316,000**	**2,731,359**	**40,779,122**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	667,000	22,000	0	22,000	689,000
09120	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	21,668,720	1,071,700	2,000	1,073,700	22,742,420
09230	Arsimi i Mesem (i pergjithshem)	6,152,043	821,787	0	821,787	6,973,830
09450	Arsimi Universitar	9,000,000	385,672	100,000	485,672	9,485,672
09770	Fonde per Shkencen	340,000	100,000	200,000	300,000	640,000
08140	Zhvillimi i Sportit dhe Rinise	220,000	14,200	14,000	28,200	248,200
12	**Ministria e Kultures**	**1,455,881**	**532,000**	**180,323**	**712,323**	**2,168,204**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	155,000	0	0	0	155,000
08220	Trashegimia Kulturore dhe Muzete	535,881	15,500	35,323	50,823	586,704
08230	Arti dhe Kultura	765,000	516,500	145,000	661,500	1,426,500
13	**Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale**	**63,523,940**	**1,501,974**	**990,000**	**2,491,974**	**66,015,914**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	394,340	4,128	0	4,128	398,468
07220	Sherbimet e Kujdesit Paresor	7,645,862	450,346	0	450,346	8,096,208

Kodi	Emertimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Financim i Brendshem	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
07330	Sherbimet e Kujdesit Dytesor	26,258,450	1,007,418	950,000	1,957,418	28,215,868
07450	Sherbimet e Shendetit Publik	2,984,428	3,000	0	3,000	2,987,428
07460	Sherbimi Kombetar i Urgjences	302,600	23,182	0	23,182	325,782
10430	Perkujdesi Social	24,902,260	12,700	40,000	52,700	24,954,960
01190	Rehabilitimi i te Perndjekurve Politik	1,036,000	1,200	0	1,200	1,037,200
14	**Ministria e Drejtesise**	**8,345,373**	**439,174**	**225,000**	**664,174**	**9,009,547**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	336,966	100,300	225,000	325,300	662,266
03310	Ndihma Juridike	45,400	0	0	0	45,400
01120	Publikimet Zyrtare	43,165	5,000	0	5,000	48,165
01130	Mjekesia Ligjore	72,890	10,000	0	10,000	82,890
03440	Sistemi i Burgjeve	5,362,916	320,374	0	320,374	5,683,290
03350	Sherbimi i Permbarimit Gjyqesor	129,100	0	0	0	129,100
01160	Sherbimet per çeshtjet e biresimeve	8,970	2,000	0	2,000	10,970
01180	Sherbimi i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave	2,105,196	1,000	0	1,000	2,206,196
03490	Sherbimi i Proves	140,770	500	0	500	141,270
15	**Ministria e Evropes dhe Puneve te Jashtme**	**3,099,100**	**29,500**	**134,780**	**164,280**	**3,263,380**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	133,600	2,000	0	2,000	135,600
01120	Mbeshtetje diplomatike jashte shtetit	2,636,500	7,000	0	7,000	2,643,500
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	237,000	0	0	0	237,000
01150	Mbeshtetja Institucionale per Procesin e Integrimit	92,000	20,500	134,780	155,280	247,280
16	**Ministria e Brendshme**	**18,897,729**	**1,382,551**	**718,868**	**2,101,419**	**20,999,148**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,025,500	612,400	0	612,400	1,637,900
03140	Policia e Shtetit	15,230,729	642,151	685,868	1,328,019	16,558,748
03150	Garda e Republikes	1,520,000	55,000	0	55,000	1,575,000
01160	Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara te Pushtetit Vendor	483,000	71,000	33,000	104,000	587,000
01170	Sherbimi i Gjendjes Civile	638,500	2,000	0	2,000	640,500
17	**Ministria e Mbrojtjes**	**18,950,081**	**3,608,327**	**119,250**	**3,727,577**	**22,677,658**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,229,000	29,650	0	29,650	1,258,650
02120	Forcat e Luftimit	5,060,707	2,784,764	0	2,784,764	7,845,471
09430	Arsimi Ushtarak	564,550	10,110	0	10,110	574,660
02150	Mbeshtetja e Luftimit	5,614,960	232,803	0	232,803	5,847,763
07340	Mbeshtetje per Shendetesine	1,106,864	50,000	0	50,000	1,156,864
10270	Mbeshtetje Sociale per Ushtaraket	5,060,000	0	0	0	5,060,000
10910	Emergjencat Civile	314,000	501,000	119,250	620,250	934,250
18	**Sherbimi Informativ Shteteror**	**1,795,000**	**46,500**	**0**	**46,500**	**1,841,500**
03520	Veprimtaria Informative Shteterore	1,795,000	46,500	0	46,500	1,841,500
19	**Drejtoria e Radio Televizionit**	**564,000**	**70,000**	**0**	**70,000**	**634,000**
08310	Sherbimet per shqiptaret jashte kufirit	270,000	0	0	0	270,000
08520	Projekte teknike per futjen e teknologjive te reja	180,000	70,000	0	70,000	250,000
08330	Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarekombetare	60,000	0	0	0	60,000
08340	Orkestra simfonike e RTSH dhe Kinematografise	54,000	0	0	0	54,000
20	**Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave**	**179,000**	**105,000**	**0**	**105,000**	**284,000**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	179,000	105,000	0	105,000	284,000
22	**Akademia e Shkences**	**189,600**	**2,000**	**0**	**2,000**	**191,600**
01520	Veprimtaria Akademike	189,600	2,000	0	2,000	191,600
24	**Kontrolli Larte i Shtetit**	**384,000**	**18,000**	**18,036**	**36,036**	**420,036**
01120	Veprimtaria Audituese e KLSH	384,000	18,000	18,036	36,036	420,036
26	**Ministria e Turizmit dhe Mjedisit**	**1,333,630**	**445,679**	**779,000**	**1,224,679**	**2,558,309**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	196,000	2,171	0	2,171	198,171
05320	Programe per mbrojtjen e Mjedisit	544,000	101,253	409,000	510,253	1,054,253
04260	Administrimi i Pyjeve	437,000	87,962	320,000	407,962	844,962
04760	Zhvillimi i Turizmit	156,630	254,293	50,000	304,293	460,923
28	**Prokuroria e Pergjithshme**	**2,168,800**	**130,000**	**0**	**130,000**	**2,298,800**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2,168,800	130,000	0	130,000	2,298,800
29	**Këshilli I Lartë I Gjyqësor**	**2,836,150**	**208,000**	**0**	**208,000**	**3,044,150**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	243,150	49,600	0	49,600	292,750
03310	Buxheti Gjyqesor	2,593,000	158,400	0	158,400	2,751,400
30	**Gjykata Kushtetuese**	**113,000**	**2,000**	**0**	**2,000**	**115,000**
03320	Veprimtaria Gjyqesore Kushtetuese	113,000	2,000	0	2,000	115,000
31	**Agjensia Telegrafike Shqiptare**	**66,650**	**1,000**	**0**	**1,000**	**67,650**
08320	Veprimtaria Telegrafike e ATSH-se	66,650	1,000	0	1,000	67,650
35	**Këshilli I Lartë I Prokurorisë**	**126,524**	**17,000**	**0**	**17,000**	**143,524**
01110	Veprimtaria e KLP	126,524	17,000	0	17,000	143,524
40	**Partite Politike**	**160,850**	**0**	**0**	**0**	**160,850**
01110	Mbeshtetje per Partite Politike	150,850	0	0	0	150,850
01120	Mbeshtetje per Shoqatat	8,000	0	0	0	8,000
01130	Mbeshtetje per Organizatat e Veteraneve me Status	2,000	0	0	0	2,000
41	**Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar**	**341,055**	**20,000**	**0**	**20,000**	**361,055**
03390	Veprimtaria e SPAK	341,055	20,000	0	20,000	361,055
50	**Instituti Statistikes**	**613,000**	**74,000**	**131,000**	**205,000**	**818,000**
01320	Veprimtaria Statistikore	613,000	74,000	131,000	205,000	818,000
55	**Shkolla e Magjistratures**	**187,000**	**3,000**	**0**	**3,000**	**190,000**
09820	Veprimtaria Arsimore	187,000	3,000	0	3,000	190,000
56	**Fondi i Zhvillimit Shqiptar**	**0**	**9,896,000**	**5,852,000**	**15,748,000**	**15,748,000**
06210	Programe Zhvillimi	0	6,196,000	5,852,000	12,048,000	12,048,000
06220	Infrastruktura Vendore dhe Rajonale	0	3,500,000	0	3,500,000	3,500,000
04230	Programi "100 Fshatrat"	0	200,000	0	200,000	200,000
57	**Qendra Kombetare e Kinematografise**	**146,220**	**1,000**	**13,400**	**14,400**	**160,620**
08220	Mbeshtetja e veprimtarise kinematografike	146,220	1,000	13,400	14,400	160,620
63	**Institucionet e sistemit te drejtesise**	**417,000**	**14,000**	**0**	**14,000**	**431,000**
03320	Veprimtaria e Inspektoriatit te Larte te Drejtesise	39,900	7,000	0	7,000	46,900
03330	Veprimtaria e rivlerësimit kalimtar të magjistratit	186,200	4,000	0	4,000	190,200
03340	Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar	125,000	2,000	0	2,000	127,000
03360	Veprimtaria e komisionerit publik	65,900	1,000	0	1,000	66,900
66	**Avokati i Popullit**	**113,540**	**1,000**	**0**	**1,000**	**114,540**
03320	Sherbimi i avokatise	113,540	1,000	0	1,000	114,540
67	**Komisioneri per Mbikqyrjen e Sherbimit Civil**	**54,466**	**0**	**0**	**0**	**54,466**

Kodi	Emertimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Financim i Brendshem	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	54,466	0	0	0	54,466
73	**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**	**125,600**	**673,500**	**0**	**673,500**	**799,100**
01610	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	125,600	673,500	0	673,500	799,100
01620	Zgjedhjet e pergjithshme dhe lokale	0	0	0	0	0
76	**Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave**	**152,500**	**2,000**	**0**	**2,000**	**154,500**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	152,500	2,000	0	2,000	154,500
77	**Autoriteti i Konkurences**	**74,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**75,500**
04120	Mbikqyrja e tregut & Garantimi i konkurences	74,500	1,000	0	1,000	75,500
82	**Keshilli Kombetar i Kontabilitetit**	**11,120**	**1,000**	**0**	**1,000**	**12,120**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	11,120	1,000	0	1,000	12,120
87	**Institucione te tjera Qeveritare**	**5,138,656**	**1,750,234**	**320,800**	**2,071,034**	**7,209,690**
01320	Sherbime Qeveritare	250,000	30,000	0	30,000	280,000
01130	Sherbimi i Prokurimit Publik	58,300	8,000	0	8,000	66,300
01120	Sherbimi per diasporen	115,500	76,750	0	76,750	192,250
05640	Administrimi I ujrave	80,900	5,000	93,000	98,000	178,900
03310	Sherbimi i Avokatise Shteterore	212,000	1,000	0	1,000	213,000
01150	Sherbime te tjera	390,489	26,500	0	26,500	416,989
01140	e-Qeverisja	3,569,567	1,518,984	7,800	1,526,784	5,096,351
01330	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administrates Publike	330,500	84,000	220,000	304,000	634,500
08480	Mbeshtetje per Kultet Fetare	131,400	0	0	0	131,400
88	**Mbeshtetje per Shoqerine Civile**	**82,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**83,500**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	82,500	1,000	0	1,000	83,500
89	**Komisioneri për te Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**	**65,626**	**1,000**	**0**	**1,000**	**66,626**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	65,626	1,000	0	1,000	66,626
90	**Komisioni I Prokurimit Publik**	**62,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**63,000**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	62,000	1,000	0	1,000	63,000
91	**Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi**	**49,810**	**1,000**	**0**	**1,000**	**50,810**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	49,810	1,000	0	1,000	50,810
92	**Instituti i Studimeve te Krimeve te Komunizmit**	**30,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**31,500**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	30,500	1,000	0	1,000	31,500
95	**Autoriteti per te Drejten e Informimit**	**77,000**	**1,000**	**8,000**	**9,000**	**86,000**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	77,000	1,000	8,000	9,000	86,000
	TOTALI	**246,339,639**	**60,652,999**	**27,684,300**	**88,337,299**	**334,676,938**

Transferta e pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2020

Tab.3

Në mijë lekë

Nr.	Bashkitë	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme 2020	Shtesë nga Kuvendi, "Transfertë e pakushtëzuar për vitin 2020"	Shtesë me Akt-Normativ, "Transfertë e pakushtëzuar për vitin 2020"	Transfertat e pakushtëzuara sektoriale											Totali
					Konviktet e arsimit parauniversitar	Arsimi parashkollor		Arsimi parauniversitar	Mbrojtja nga zjarri	Mbrojtja sociale	Administrimi i pyjeve	Rrugët	Ujitja dhe Kullimi	Klubet shumësportëshe "Partizani dhe "Studenti"	Shtesë nga Kuvendi "Transfertë e pakushtëzuar sektoriale për investime në rrugë"	
						Ndarë me formulë për personelin mësimor	Për stafin mbështetës									
1	Belsh	119,458			0	25,140	1,434	1,199	12,944	0	814	7,828	9,589			**178,406**
2	Berat	293,099			27,374	97,221	37,282	13,579	30,550	23,731	5,151	4,824	14,250			**547,061**
3	Bulqizë	261,586			0	50,199	9,339	0	14,005	0	8,745	28,565	12,850			**385,289**
4	Cërrik	140,804			4,595	40,811	5,144	4,557	13,107	0	1,160	1,798	13,550			**225,527**
5	Delvinë	65,565	10,000		0	19,106	4,660	1,739	13,067	0	2,321	3,372	9,589			**129,418**
6	Devoll	189,509			0	50,797	3,280	2,423	13,292	0	4,110	10,385	10,990			**284,785**
7	Dibër	409,240			24,070	112,440	27,495	9,261	22,905	0	7,523	14,002	13,550			**640,485**
8	Divjakë	210,800			0	50,678	1,398	1,268	12,393	0	818	7,754	28,594			**313,704**
9	Dropull	80,991			0	2,370	484	1,102	12,944	0	4,062	5,020	5,970			**112,942**
10	Durrës	842,614			22,735	172,049	47,069	18,240	48,405	0	2,920	23,932	43,047			**1,221,012**
11	Elbasan	675,697	20,000		28,446	209,187	54,059	32,192	30,890	21,108	11,084	17,421	14,250			**1,114,334**
12	Fier	594,627			21,273	159,437	38,680	10,679	33,084	26,000	3,681	8,494	56,238			**952,192**
13	Finiq	118,538	15,000		0	8,275	1,421	0	12,393	0	3,250	2,798	14,951			**176,625**
14	Fushë Arrëz	77,686		2,000	0	21,744	9,321	4,484	13,107	0	10,750	13,388	2,709			**155,189**
15	Gjirokastër	210,664			18,070	75,372	23,301	5,869	28,584	0	6,412	7,639	9,230			**385,141**
16	Gramsh	212,298	25,000		6,455	65,041	8,388	3,604	13,851	0	10,578	19,367	9,589		90,000	**464,170**
17	Has	141,374			6,729	29,331	3,280	2,857	14,706	0	8,111	1,589	9,589			**217,565**
18	Himarë	118,403			0	13,777	950	602	12,508	0	7,188	4,448	9,589			**167,467**
19	Kamëz	504,614			0	126,940	20,057	9,748	12,393	0	500	0	3,409			**677,661**
20	Kavajë	214,912	25,000	3,000	12,721	66,595	15,845	6,390	16,543	0	818	5,585	18,912			**386,321**
21	Këlcyrë	60,191			0	7,703	1,398	2,767	13,107	0	2,896	7,639	9,589			**105,291**
22	Klos	137,653			0	24,380	5,126	1,752	12,944	0	6,439	10,028	2,709			**201,030**
23	Kolonjë	120,195			9,717	28,633	5,126	3,971	13,216	0	11,155	8,895	15,289			**216,197**
24	Konispol	59,580			0	10,250	1,434	0	12,944	0	1,582	1,722	10,289			**97,802**
25	Korçë	449,034			21,881	134,459	40,544	18,289	29,092	0	13,815	6,521	43,178			**756,814**
26	Krujë	283,848			0	77,748	15,397	3,527	15,018	0	5,460	7,086	15,651			**423,735**
27	Kuçovë	161,955			0	54,925	17,243	6,762	14,185	2,622	1,342	2,006	12,850			**273,889**
28	Kukës	318,971		6,000	19,437	84,440	29,359	4,791	45,583	2,498	9,579	19,147	5,970			**545,774**
29	Kurbin	228,683			0	73,731	17,261	14,838	13,576	0	2,585	3,857	19,612			**374,143**
30	Lezhë	325,524			9,300	89,387	25,632	15,307	28,991	0	7,204	5,158	21,714			**528,215**
31	Libohovë	41,356			0	5,625	1,434	1,112	12,944	0	2,483	6,329	2,709			**73,993**
32	Librazhd	273,492	25,000		0	63,860	9,339	3,065	13,851	0	8,024	24,003	12,850			**433,482**
33	Lushnje	400,677	15,000		9,249	129,240	28,912	11,051	14,569	0	1,588	7,304	44,579			**662,169**
34	Malësi e Madhe	290,957		4,000	4,208	44,048	2,796	5,115	18,764	0	11,970	12,868	11,690			**406,417**
35	Maliq	293,303			0	73,267	3,764	10,018	12,944	0	5,278	8,645	37,816			**445,036**
36	Mallakastër	158,882			0	55,554	14,447	6,576	14,512	0	2,619	7,138	12,850			**272,577**
37	Mat	187,686		4,000	12,604	50,620	17,243	5,769	14,005	0	7,402	25,057	9,589			**333,975**
38	Memaliaj	103,316			0	29,332	4,660	7,246	12,944	0	3,000	4,365	2,709			**167,572**
39	Mirditë	201,236		10,000	21,882	43,963	14,913	7,356	15,708	0	12,325	18,662	12,850			**358,894**
40	Patos	126,611			0	39,721	11,651	3,470	14,512	0	1,000	1,798	14,289			**213,051**
41	Peqin	128,273	10,000		0	33,329	4,678	3,788	13,574	0	1,321	4,289	9,589			**208,840**
42	Përmet	118,211			6,564	20,629	4,660	4,618	13,454	0	5,314	6,766	9,589			**189,806**
43	Pogradec	356,705	20,000		0	118,433	7,009	9,270	13,672	0	11,399	20,303	10,289			**567,080**
44	Poliçan	99,488			0	23,986	6,410	3,953	13,450	0	3,218	3,400	2,709			**156,613**
45	Përrenjas	170,645	10,000		0	37,886	4,697	2,875	13,107	0	5,304	18,293	9,589			**272,397**
46	Pukë	111,972		7,000	13,676	27,727	11,651	6,702	14,465	0	10,531	6,408	2,709			**212,842**
47	Pustec	34,566			0	5,527	300	0	13,861	0	802	309	2,709			**58,074**

48	Roskovec	109,778			0	28,055	2,348	2,275	12,944	0	1,000	3,928	6,670			**166,998**
49	Rrogozhinë	142,093	25,000	2,000	0	29,550	5,610	2,313	12,393	0	1,299	0	9,589		110,000	**339,848**
50	Sarandë	129,131			18,371	41,878	12,117	3,543	17,736	0	2,374	0	5,970			**231,120**
51	Selenicë	167,390			0	23,946	4,213	7,675	12,944	0	4,167	2,726	12,850			**235,911**
52	Shijak	134,908			0	34,604	6,059	2,923	12,393	0	818	47	5,970			**197,723**
53	Shkodër	648,181			57,888	115,426	49,399	24,189	34,441	36,164	10,372	18,580	26,734			**1,021,374**
54	Skrapar	122,367		18,000	11,080	32,972	10,367	6,342	13,571	0	3,960	12,543	9,589			**240,789**
55	Tepelenë	82,198			6,729	30,666	7,456	3,445	13,454	0	4,635	6,111	2,709			**157,403**
56	Tiranë	2,424,942			89,902	566,413	241,400	85,553	111,663	0	9,050	19,628	20,430	32,000		**3,600,982**
57	Tropojë	206,870		7,000	0	37,620	10,718	3,490	14,705	0	11,957	8,646	2,709			**303,714**
58	Ura Vajgurore	136,631		7,000	0	43,853	484	1,576	13,067	0	802	3,736	17,870			**225,019**
59	Vau i Dejës	220,570			8,720	37,237	968	2,293	12,393	19,190	6,070	5,661	11,690			**324,793**
60	Vlorë	543,546			25,769	191,903	61,049	31,053	34,350	0	5,488	2,696	37,763			**933,617**
61	Vorë	118,949			0	40,204	2,348	4,923	12,393	0	814	484	9,589			**189,705**
Totali		**15,913,043**	**200,000**	**70,000**	**519,441**	**4,039,238**	**1,034,504**	**475,376**	**1,149,114**	**131,313**	**318,440**	**520,992**	**856,538**	**32,000**	**200,000**	**25,460,000**

TREGUESIT FISKALË TË BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2020
Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2020
në milionë lekë (in million lek)

Tab.4

Nr.	E M E R T I M I	AN nr.34 date 16.12.2020	Ne % te PBB	I T E M S
	TOTALI TE ARDHURAVE	**446,570**	**28.2%**	**TOTAL REVENUE**
I.	**Te ardhura nga ndihmat**	**16,000**	**1.0%**	**Grants**
	Nga te cilat: mbeshtetje buxhetore	*2,500*	*0.2%*	*from which: Budget Support*
	Nga te cilat: grante per fondin e rindertimit	*3,000*	*0.2%*	*from which: Reconstruction Fund*
	Nga te cilat: grante/donacione te tjera	*10,500*		
II.	**Te ardhura tatimore**	**410,045**	**25.9%**	**Tax Revenue**
II.1	**Nga Tatimet dhe Doganat**	**290,000**	**18.3%**	**From tax offices and customs**
	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	130,760	8.3%	V.A.T
	Tatimi mbi Fitimin	30,390	1.9%	Profit Tax
	Akcizat	45,300	2.9%	Excise Tax
	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	41,080	2.6%	Personal Income Tax
	Taksa Nacionale dhe te tjera	36,010	2.3%	National Taxes and others
	Taksa Doganore	6,462	0.4%	Customs Duties
II.2	**Te ardhura nga Pushteti Vendor**	**23,045**	**1.5%**	**Local Taxes**
	Taksa Lokale	18,422	1.2%	Local Taxes
	Tatimi mbi Pasurine (ndertesat)	4,254	0.3%	Property Tax
	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel	369	0.0%	Simple profit tax of small bisness
II.3	**Te ardhurat nga Fondet Speciale**	**97,000**	**6.1%**	**Revenues from Special Funds**
	Sigurimi Shoqeror	82,540	5.2%	Social Insurance
	Sigurimi Shendetesor	13,460	0.9%	Health insurance
	Te ardhurat per kompensimin ne vlere te pronareve	1,000	0.1%	Revenues for owners' in value-compensation
III.	**Te ardhura Jotatimore**	**20,525**	**1.3%**	**Nontax Revenue**
	Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise	1,398	0.1%	Profit transfer from BOA
	Te ardhura nga Institucionet Buxhetore	12,527	0.8%	Income of budgetary institutions
	Dividenti	500	0.0%	Divident
	Tarifat e Sherbimeve	2,000	0.1%	Services Fees
	Te tjera	4,100	0.3%	Others
	TOTALI I SHPENZIMEVE	**579,535**	**36.7%**	**TOTAL EXPENDITURE**
I.	**Shpenzime Korrente**	**441,998**	**28.0%**	**Current Expenditures**
1	**Personeli**	**81,134**	**5.1%**	**Personnel expenditures**
	Paga	68,847	4.4%	Wages
	Kontributi per Sigurime Shoqerore	11,267	0.7%	Social insurance contributions
	Fondi i vecante i pagave	240	0.0%	Bonus fund
	Arsimi i Larte nga te ardhurat e veta	780	0.0%	Higher Education from its own revenues
2	**Interesat**	**39,160**	**2.5%**	**Interest**
	Te Brendshme	22,610	1.4%	Domestic
	Te Huaja	12,450	0.8%	Foreign
	Kontingjencë për risqet e borxhit	4,100	0.3%	Contingency for debt related risks
3	**Shpenzime Operative Mirembajtje nga te cilat:**	**51,287**	**3.2%**	**Operational & Maintenance of which:**
	Te qeverisjes qendrore	*48,193*	*3.0%*	*Central government*
	Arsimi i Larte nga te ardhurat e veta	*900*	*0.1%*	*from revenues of Higher Education System*
	Te tjera jashte limitit	*2,194*	*0.1%*	*from Exceptional Revenues*
4	**Subvencionet**	**1,960**	**0.1%**	**Subsidies**
5	**Shpenzime per Fondet Speciale**	**189,372**	**12.0%**	**Social insurance outlays**
	Sigurime Shoqerore	138,668	8.8%	Social insurance
	Nga e cila: Shperblimi per Pensionistet	3,400		
	Politika te reja pensionesh	2,100	0.1%	Contingency for new pension policies
	Sigurime Shendetesore	45,704	2.9%	Health insurance
	Nga e cila: Mbeshtetjen shendetesore anti-COVID	*2,500*	*0.2%*	
	Shpenzime per Kompensimin ne Vlere te Pronareve	2,900	0.2%	Expenditure for owners' in value-compensation
6	**Shpenzime per Buxhetin Vendor**	**53,285**	**3.4%**	**Local Budget expenditure**
	Transfertat nga Buxheti i Shtetit per pushtetin vendor	26,110	1.7%	Central Government Grant for Local Government
	Transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme	*18,270*	*1.2%*	*Unconditional Fund*
	Transfertë e pakushtëzuar sektoriale (Grant Specifik)	*7,840*	*0.5%*	*Specific Grant*
	Buxheti vendor (të ardhurat e veta tatimore)	23,045	1.5%	Local Budget (Own revenues)
	Taksa të ndara	800	0.1%	Local Budget (from shared taxes revenues)
	Buxheti vendor (të ardhurat e veta jo-tatimore)	2,800	0.2%	Local Budget (from non-tax revenues)
	Financimi i huaj vendor	530	0.0%	Local foreign financing
7	**Shpenzime te tjera**	**25,800**	**1.6%**	**Other expenditures**
	Pagesa e Papunesise	800	0.1%	Unemployment insurance benefits
	Ndihma Ekonomike dhe Paaftesia	22,000	1.4%	Social assistance and disability
	Kompensim per ish te perndjekurit politike	1,000	0.1%	Compensation for ex political prisoners
	Bonusi i lindjeve	2,000	0.1%	Birth Bonus
II.	**Fondi Rezerve**	**16,200**	**1.0%**	**Reserve fund, Contingency**
	Fondi Rezerve	2,700	0.2%	Reserve Fund
	Kontigjenca per paketen sociale anti-COVID	13,500	0.9%	Contingency for deficit financing
III.	**Shpenzime Kapitale**	**89,337**	**5.7%**	**Capital expenditures**
	Financimi Brendshem	60,653	3.8%	Domestic financing
	Nga e cila: Transferte per Shpronesime	200	0.0%	
	Investime nga te ardhurat e Arsimit te Larte	1,000	0.1%	From Higher Education System's own revenues
	Financimi Huaj	27,684	1.8%	Foreign financing
	nga të cilat: Energjia	*1,000*	*0.1%*	*from which: Energy*
IV	**Fondi I Rindertimit, nga të cilat:**	**32,000**	**2.0%**	**Reconstruction Fund**
	Grante	**3,000**	**0.2%**	
	Shpenzime	**29,000**		
	DEFIÇITI	**-132,965**	**-8.4%**	**Cash Balance**
	FINANCIMI DEFIÇITIT	**132,965**	**8.4%**	**Financing (Cash)**
	Brendshem	**50,371**	**3.2%**	**Domestic**
	Te ardhura nga privatizimi		0.0%	Privatization receipts
	Hua-marrje e brendshme	49,900	3.2%	Domestic borrowing
	Te tjera	471	0.0%	Other
	I Huaj	**82,594**	**5.2%**	**Foreign**
	Hua afatgjate (e marre)	97,361	6.2%	Long-term Loan(Drawings)
	Ndryshimi i gjendjes se arkes	0		Chang. of stat. Account
	Ripagesat	-62,600	-4.0%	Repayments
	Mbeshtetje buxhetore	47,833	3.0%	Budget support
	Produkti i Brendshem Bruto (PBB)	***1,580,960***	***100.0%***	***Gross Domestic Product (GDP)***

AKTNORMATIV
Nr.35, datë 16.12.2020

PËR NJË SHTESË NË AKTIN NORMATIV NR.1, DATË 31.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MASAT PARANDALUESE NË KUADËR TË FORCIMIT TË LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT, KRIMIT TË ORGANIZUAR, KRIMEVE TË RËNDA DHE KONSOLIDIMIT TË RENDIT E SIGURISË PUBLIKE", MIRATUAR ME LIGJIN NR.18/2020

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Pas paragrafit të parë, të nenit 38, të aktit normativ nr.1, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Kërkesat për marrjen e masave parandaluese, të depozituara nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit deri në datën 31.12.2020, vazhdojnë të shqyrtohen nga gjykata dhe prokuroria kompetente, të përcaktuara në nenin 9, sipas kompetencës, rregullave dhe procedurave të parashikuara në këtë akt normativ.".

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 1008, datë 25.11.2020

PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË HARTIMIT TË PROGRAMEVE TË VEÇANTA TË SHTETËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të nenit 9, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë (në vijim AHPVSH), si person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet e shtetësisë dhe azilit (në vijim ministri), me seli në Tiranë.

2. AHPVSH-ja ka buxhetin e vet, burimet e financimit, të cilat janë:

a) buxheti i shtetit;

b) të ardhura e krijuara nga tarifat dhe shërbimet e parashikuara në zbatim të programeve të veçanta sipas misionit të saj;

c) donacione dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

3. AHPVSH-ja ka si mision përgatitjen e programeve të veçanta, përcaktimin e rregullave specifike të kontrollit të veçantë dhe të pastërtisë së figurës në standardet më të larta, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre.

KREU II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AHPVSH-së

4. AHPVSH-ja e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror.

5. AHPVSH-ja drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e saj dhe përgjigjet para ministrit.

6. Struktura dhe organika e AHPVSH-së miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

7. AHPVSH-ja kryen detyrat, si më poshtë vijon:

a) përgatit kriteret teknike të programeve të veçanta me interes kombëtar apo me interes në fushën e arsimit, shkencës, artit, kulturës, ekonomisë e sportit për fitimin e shtetësisë shqiptare nga shtetas të huaj që investojnë në Shqipëri ose kontribuojnë në zhvillimin arsimor, shkencor, artistik-kulturor, ekonomik e sportiv të vendit dhe ia propozon për miratim autoritetit përkatës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

b) përgatit kriteret teknike për fitimin e shtetësisë, sipas programeve të veçanta të përcaktuara në shkronjën "a", të kësaj pike, procedurat e aplikimit, rregullat e kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme dhe ia propozon për miratim autoritetit përkatës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

c) përgatit rregulla specifike të kontrollit të veçantë dhe të pastërtisë së figurës në standardet më të larta të kontrollit, ia propozon për miratim autoritetit përkatës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, dhe ndjek e monitoron zbatimin e tyre;

d) harton, implementon dhe administron programet e veçanta. Në bazë të procedurave ligjore përkatëse, nënshkruan marrëveshje me entitete të specializuara për hartimin, implementimin, administrimin, promovimin ndërkombëtar të programeve, ndërmjetësimin e aplikimeve, verifikimin e pastërtisë së figurave, si dhe çdo shërbim tjetër në funksion të hartimit dhe implementimit të programeve, bazuar ne eksperiencat më të mira ndërkombëtare;

dh) shqyrton aplikimet për përputhshmërinë e kritereve për fitimin e shtetësisë, realizon verifikimet e kontrollet në lidhje me pastërtinë e figurës dhe, në rast të plotësimit të kushteve të përcaktuara në programet e veçanta të miratuara sipas legjislacionit në fuqi, u përcjell autoriteteve kompetente propozimin për vendimmarrje;

e) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse të fushës së arsimit, shkencës, artit, kulturës, ekonomisë e sportit për hartimin e programeve të veçanta me interes kombëtar;

ë) kryen çdo detyrë tjetër që nuk bie ndesh me kompetencat e institucioneve të tjera shtetërore në përmbushje të misionit të saj.

8. Drejtori i Përgjithshëm i AHPVSH-së emërohet, lirohet ose shkarkohet me urdhër të Kryeministrit, pas propozimit të ministrit përgjegjës për çështjet e shtetësisë dhe azilit. Drejtori i Përgjithshëm duhet të ketë të paktën 5 (pesë) vite eksperiencë pune në organet e administratës shtetërore.

9. Drejtori i Përgjithshëm ka kompetenca dhe kryen këto detyra:

a) drejton aktivitetin e AHPVSH-së sipas objektivave politikë të Këshillit të Ministrave, planeve strategjike dhe programeve të performancës;

b) miraton urdhra e udhëzime për funksionimin, zhvillimin, përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të AHPVSH-së dhe të aktivitetit në zbatim të legjislacionit për çështjet e shtetësisë;

c) i paraqet ministrit për miratim kriteret e veçanta që duhet të plotësohen nga personeli i AHPVSH-së, rregullat për testimin e aftësive profesionale, si dhe planet për trajnimin e burimeve njerëzore;

ç) emëron e liron personelin e AHPVSH-së;

d) i paraqet ministrit përgjegjës për çështjet e shtetësisë dhe azilit raportin vjetor për veprimtarinë e institucionit, si dhe raporte periodike;

dh) i propozon ministrit përgjegjës për çështjet e shtetësisë dhe azilit miratimin e tarifave të shërbimit, si dhe ndërmarrjen e nismës për rishikimin apo ndryshimin e tarifave të shërbimeve të ofruara nga AHPVSH-ja, me qëllim mbulimin e kostove të shërbimit dhe menaxhimin me eficiencë të të ardhurave;

e) përfaqëson ligjërisht AHPVSH-në në marrëdhënie me të tretët;

ë) propozon rregulloret që miratohen nga ministri përgjegjës për çështjet e shtetësisë dhe azilit;

f) i paraqet ministrit përgjegjës për çështjet e shtetësisë dhe azilit projektaktet që propozohen për shqyrtim në Këshillin e Ministrave me karakter individual dhe normativ;

g) detyra të tjera të parashikuara në ligje apo në akte nënligjore.

10. Rregullorja që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të AHPVSH-së miratohet nga ministri përgjegjës për çështjet e shtetësisë dhe azilit, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm.

11. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm, të nëpunësve dhe të punonjësve të AHPVSH-së rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

12. AHPVSH-ja ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare. Stema e AHPVSH-së është në përputhje me përcaktimet e vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

13. Vula e AHPVSH-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet e ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU III
DISPOZITA TË FUNDIT

14. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr.1040, datë 25.11.2020

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË ZBATIMIT TË KRITEREVE TË LEGALIZIMIT DHE MIRATIMIN E MODELIT TË AKTIT TË LEGALIZIMIT, PËR NDËRTIMET PA LEJE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 18, pika 4, e 21, pika 3, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

a) "Zonë informale", territori, kufiri i të cilit është miratuar me vendim të ish-Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, ose Këshillit Kombëtar të Territorit, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë";

b) "Zonë urbane", territori i destinuar për zhvillime ndërtimore, sipas përcaktimit në dokumentin e miratuar të planifikimit të territorit (PPV), ose sipas përcaktimeve të vendimit nr.5, datë 29.12.2014, të Këshillit Kombëtar të Territorit, të cilit ASHK-ja i referohet për njësitë administrative, që nuk kanë dokument të miratuar të planifikimit të territorit (PPV);

c) "Kufi rrugor", fundi i trupit të rrugës, që e ndan atë nga pasuritë e tjera të paluajtshme dhe që identifikohet në dokumentacionin e krijimit të veprës rrugore ose, në mungesë të tij, në procedurat e përcaktuara në pikën 19, të këtij vendimi. Identifikimi i kufirit rrugor nuk bëhet nga kartela dhe harta kadastrale e pasurisë rrugë. Këto të fundit, pas identifikimit të kufirit të rrugës, nëse është rasti, i nënshtrohen korrigjimit/përmirësimit, në përputhje me legjislacionin për kadastrën;

ç)"Trup rruge", vetë prona e paluajtshme rrugë, që përbëhet nga hapësira territoriale midis dy kufijve rrugorë të saj dhe që përfshin elementet e parashikuara nga Kodi Rrugor, kur ata janë të pranishëm;

d) "Rrugë jo kombëtare", janë rrugët e kategorizuara nga Kodi Rrugor si D, E, F, si dhe segmentet e rrugëve C, që gjenden brenda zonës informale, ose zonës urbane;

dh) "Territor i ndërtesës publike", sipërfaqja e truallit funksional të ndërtesës publike apo që rezulton të jetë pjesë e inventarit për këtë ndërtesë, si: godinat e institucioneve shtetërore, të shkollave e kopshteve publike, spitaleve, qendrave shëndetësore, kampuseve studentore e të tjera të ngjashme;

e) "Vija bregdetare", vija e miratuar me vendimin nr.2, datë 14.6.2016, të Këshillit Kombëtar të Territorit, "Për miratimin e Planit të Integruar Sektorial për brezin bregdetar'";

ë) "Pasuri kulturore të paluajtshme të grupuara", ka të njëjtin kuptim si në shkronjën "b", të pikës 3, të nenit 53, të ligjit nr.27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë";

f) "Vija blu", vija mbrojtëse e brigjeve, e përcaktuar në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, që merret parasysh në kuadër të procedurave të legalizimit vetëm për ndërtimet jashtë zonave urbane dhe atyre informale;

g) "Objekt ndihmës", objekti pa leje që, nga ana funksionale, i shërben një ndërtimi tjetër, pa leje apo të ligjshëm, edhe nëse nga ana ndërtimore-strukturore qëndron më vete. Të tilla janë garazhdet e veçuara nga ndërtimi kryesor dhe rastet e tjera të ngjashme.

2. Ndërtimet pa leje kualifikohen për legalizim kur:

a) Cilësia ndërtimore e tyre plotëson njëkohësisht të gjitha kushtet e mëposhtme:

i. Është minimalisht i ndërtuar një kat, mbi ose nën tokë, gjysmëkat nën çati apo krijohet volumetri e shfrytëzueshme ndërtimore;

ii. Është i ngritur të paktën në strukturë, ku struktura është tërësia e elementeve horizontale dhe vertikale mbajtëse, përshirë edhe sistemin e lidhjes me tokën dhe mbulesën;

iii. Është i lidhur në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën, sipas kuptimit të nenit 143, të Kodit Civil, dhe nuk përbën "ndërtim të përkohshëm", sipas kuptimit të legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

b) Nuk gjenden në rrethanat e moslegalizimit, sipas përcaktimeve të nenit 29, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". "Shtesat pa leje në ndërtime të regjistruara" dhe "objektet me shkelje të lejes së ndërtimit" legalizohen pa iu nënshtruar kritereve të përcaktuara në këtë shkronjë. Ndërtimet pa leje të llojit "objekt", në zona, ku dokumentet e miratuara të planifikimit të territorit parashikojnë zhvillime mbi 6 kate, legalizohen kur plotësohet një nga këto kushte:

i. Një pjesë e sipërfaqes së truallit të bazës së ndërtimit, sado qoftë ajo, është në pronësi të vetë poseduesit të ndërtimit, në pronësi shtetërore, për të nuk ka informacion për pronësinë ose figuron në regjistrat e paluajtshme në favor të një të treti si "pronar i pavërtetuar", me kushtin që ky i fundit të mos ketë titull pronësie, në kuptim të nenit 193, të Kodit Civil, të dorëzuar më pare, pranë ASHK-së. Pjesa e sipërfaqes mund të jetë pasuri më vete e ndarë fizikisht, ose pjesë ideale e pasurisë në bashkëpronësi. Në rastin e pasurisë në bashkëpronësi, që është më e madhe sesa vetë baza e objektit, pjesa ideale e poseduesit të objektit ose e shtetit llogaritet nën sipërfaqen e bazës së ndërtimit.

ii. Pronari i ligjshëm-person i tretë i truallit të zënë nga sipërfaqja e bazës së ndërtimit pa leje shpreh, nëpërmjet një akti noterial vullnetin për heqjen dorë nga e drejta e zhvillimit të parcelës ndërtimore ose miratimin e legalizimit në favor të poseduesit të objektit, duke pranuar trajtimin përmes kompensimit financiar.

2.1 Objektet ndihmëse legalizohen nëse gjenden brenda së njëjtës parcelë ndërtimore me ndërtimin kryesor. Në rastin kur ndërtimi kryesor është ndërtim pa leje, atëherë ai dhe objekti ndihmës, nëse përmbushin kriteret ligjore, legalizohen nëpërmjet të njëjtit akt, sipas modelit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Objekti ndihmës, në këtë rast, nuk konsiderohet si objekt i dytë, në kuptim të nenit 23, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".

3. Njësitë ndëtimore që legalizohen sipas nenit 52, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", brenda territorit të zonave të stimuluara, nuk i nënshtrohen kritereve të moslegalizimit, të përcaktuara në këtë vendim, nëse në këto objekte nuk janë kryer zhvillime ndërtimore pa leje. Në të kundërt, nëse janë kryer të tilla, atëherë veprohet, si më poshtë vijon:

a) Për ndërtimet pa leje të llojit "objekt me shkelje të lejes së ndërtimit" veprohet sipas mënyrës së përcaktuar në pikën 3, të nenit 18, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", duke ia nënshtruar kritereve të moslegalizimit vetëm për shtesën tej lejes, përveç kriterit të shkronjës "d", të pikës 1, të nenit 18, dhe kriterit të "zonave të mbrojtura mjedisore". Nëse kjo sipërfaqe është e pandashme nga sipërfaqja sipas projektit të lejes se ndërtimit, atëherë objekti legalizohet në tërësi;

b) Ndërtimet pa leje të llojeve "objekt" dhe "shtesë në ndërtime të regjistruara", i nënshtrohen

kritereve të pikës 1, të nenit 18, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", dhe këtij vendimi, me përjashtim të atyre që lidhen me shkronjën "d", të pikës 1, të nenit të mësipërm dhe me "zonat e mbrojtura mjedisore".

4. Ndarjet e hapësirave të brendshme në ndërtime të regjistruara, që ndryshojnë sipërfaqen ndërtimore, brenda vëllimit ekzistues, legalizohen pa iu nënshtruar kritereve kualifikuese të parashikuara në këtë vendim.

5. Legalizimi i ndërtimeve pa leje nga drejtoritë vendore të ASHK-së bazohet në gjendjen faktike të tyre dhe në kriteret e përcaktuara në mënyrë shteruese në këtë vendim. Për efekt të procedurave kualifikuese, drejtoritë e ASHK-së bashkëpunojnë me institucione të tjera, duke iu përmbajtur parashikimeve të këtij vendimi. Institucionet janë të detyruara të shprehen mbi kërkesat e drejtorive vendore të ASHK-së brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga paraqitja e tyre. Në rast moskthimi të përgjigjes brenda këtij afati, ASHK-ja njofton organin epror të institucionit dhe/ose Kryeministrin.

Dokumentet e miratuara të planifikimit të territorit merren parasysh gjatë procedurës së kualifikimit vetëm për ato elemente, kushte apo kritere dhe vetëm në ato raste që janë të parashikuara shprehimisht në këtë vendim.

6. Hipotekat dhe të drejtat e tjera reale si qiratë, enfiteozat, uzufruktet, të drejtat e përdorimit, servitutet, që rëndojnë mbi tokën/pasurinë dhe që u përkasin të tretëve, nuk pengojnë legalizimin e ndërtimit pa leje. Nuk pengojnë legalizimin as kufizimet e vendosura në regjistrin e pasurive të paluajtshme dhe lloji i pasurisë, i pasqyruar në të.

6.1 Kur poseduesi i ndërtimit pa leje është njëkohësisht edhe qiramarrës i tokës ku ai ka ngritur ndërtimin, atëherë legalizimi lejohet vetëm nëse merret pëlqimi i pronarit qiradhënës. I njëjti rregull zbatohet edhe kur aplikimi për legalizim është paraqitur nga anëtarët e familjes ose gjinisë së afërt të qiramarrësit.

Kur toka është në pronësi shtetërore, vetëm pas kalimit të një afati 15-vjeçar të marrëdhënies së qirasë, mund të jepet pëlqimi nga institucioni qendror administrues i pasurisë, nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore për pronat e transferuara në pronësi apo përdorim të tyre, ose nga Këshilli i Ministrave për pronat e painventarizuara apo për të cilat ka ndalime/kufizime për kalimin e pronësisë.

Në rastet e parashikuara në këtë pikë, drejtoria vendore e ASHK-së nuk merr parasysh asnjë veprim juridiko-civil të poseduesit të ndërtimit pa leje, që ka për qëllim njohjen, apo kalimin e së drejtës së legalizimit te të tretët, në kuptim të shkronjës "a", të pikës 8, të këtij vendimi.

Rregullat e kësaj pike zbatohen edhe për enfiteozat, uzufruktet dhe të drejtat e përdorimit.

Kur qiramarrësi apo titullari i këtyre të drejtave reale është subjekt i ndryshëm nga poseduesi i ndërtimit pa leje, i tretë dhe jo anëtar i familjes së tij, atëherë legalizimi nuk pengohet, në përputhje me pikën 6, të këtij vendimi.

7. Për ndërtimet pa leje që legalizohen, vendimi i legalizimit përbën titullin e pronësisë së përfituesit të pasurisë së legalizuar, në kuptim të neneve 21 dhe 22, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". Modeli i aktit të legalizmit/moslegalizimit është sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8. Procedura e legalizimit kryhet për subjektin që, sipas rastit, është aplikuesi për legalizim ose/dhe personi të cilit i janë njohur të drejta mbi ndërtimin pa leje nëpërmjet:

a) veprimeve juridiko-civile me akt noterial, për kalimin e së drejtës së legalizimit, trashëgimisë ose deklaratës noteriale së aplikuesit, për njohjen e të drejtave të të tretit mbi ndërtimin. Dokumentacioni sipas kësaj shkronje dorëzohet nga subjektet përpara përfundimit të procedurave administrative të miratimit të aktit të legalizimit; ose

b) vendimit gjyqësor të formës së prerë.

8.1 Për ndërtimet pa leje të llojit "objekt me shkelje të lejes së ndërtimit", procedurat e legalizimit si rregull kryhen në favor të titullarit të lejes së ndërtimit si subjekt investitor, sipas vendimit të miratuar nga autoriteti kompetent për zhvillimin e territorit, ose/dhe për subjektin që i janë kaluar apo njohur të drejtat mbi ndërtimin si investitor, në bazë të rasteve të përcaktuara në pikën 8, të këtij vendimi, shkronjat "a" ose "b".

Përjashtimisht, në rastet e përcaktuara në nenin 31, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", procedurat e legalizimit kryhen në favor të poseduesve të objektit me shkelje të lejes,

që kanë hyrë në marrëdhënie kontraktore me investitorin.

Në objektet me shkelje të lejes së ndërtimit, vetëm sipërfaqet në tejkalim të lejes së ndërtimit i nënshtrohen kritereve të moslegalizimit, kur ato janë të ndashme nga ndërtimi me leje. Në rastin kur këto sipërfaqe nuk janë të ndashme, objektet me shkelje të lejes së ndërtimit legalizohen në tërësi, në përputhje me përcaktimet e pikës 3, të nenit 18, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".

8.2 Kur gjatë procedurave të legalizimit konstatohet se për të njëjtin ndërtim pa leje ka aplikime të ndryshme nga dy ose më shumë subjekte, procedurat e legalizimit vijojnë në favor të subjektit që ka aplikuar i pari në kohë, në përputhje me pikën 1, të nenit 26, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".

Në rast se ndonjë nga subjektet aplikuese apo të tretë ngrenë padi për njohjen e të drejtave të tyre mbi ndërtimin dhe ia njoftojnë atë drejtorisë vendore të ASHK-së, atëherë kjo e fundit është e detyruar që, në rast se ndërtimi legalizohet sipas përcaktimeve të këtij vendimi, ta miratojë aktin e legalizimit pa përcaktuar përfituesin, në përputhje me pikën 2, të të njëjtit nen. Drejtoria vendore e ASHK-së nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e vendimit të legalizimit, në rast se nuk është njoftuar për zhvillimin e procesit gjyqësor nga pala e interesuar, shoqëruar me vërtetimin përkatës, ose nga gjykata.

9. Për "shtesat në ndërtime të regjistruara", marrëdhënia me ndërtimin e regjistruar shqyrtohet gjatë procedurave kualifikuese, vetëm nëse, sipas evidentimit në terren, rezulton se shtesa është e lidhur pazgjidhshmërisht nga ana funksionale me të. Në këto raste, kur ndërtimi i regjistruar është tjetërsuar, procedurat e kualifikimit të shtesës kryhen në emër të pronarit të ri të tij. Përjashtimisht, me pëlqimin e shprehur të pronarit të ndërtimit të regjistruar, shtesa mund të legalizohet në emër të një subjekti tjetër edhe kur ekziston lidhja funksionale me ndërtimin ekzistues.

Kur lidhja funksionale nuk ekziston, marrëdhënia me ndërtimin e regjistruar nuk merret parasysh gjatë legalizimit.

10. Ndërtimi pa leje i llojit "shtesë në ndërtim të regjistruar", si brenda dhe jashtë zonave informale dhe zonave urbane, u nënshtrohet vetëm kritereve të përcaktuara në kreun II, të këtij vendimi, me përjashtimet e mëposhtme:

a) Kur "shtesa në ndërtim të regjistruar" bie mbi trotuaret e rrugëve jokombëtare, ajo legalizohet. Për efekt të rrugëve të kategorive A dhe B shtesat kanë të njëjtin trajtim si objektet;

b) Shtesat në parqe arkeologjike, që ndodhen jashtë zonave informale dhe atyre urbane, nuk legalizohen. Shtesat në parqe arkeologjike, por brenda zonave urbane ose zonave informale, legalizohen pa nevojën e miratimit nga autoritetet përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;

c) Shtesat në zonat arkeologjike A, si brenda dhe jashtë zonave urbane dhe zonave informale, legalizohen vetëm nëse merret miratimi nga autoritetet përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;

ç) Shtesat në zonat arkeologjike B, si brenda dhe jashtë zonave urbane dhe zonave informale, legalizohen pa nevojën për miratimin e autoriteteve përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

Në të gjitha rastet e tjera të pasurive kulturore të paluajtshme të grupuar,a të parashikuara në kreun II, të këtij vendimi, shtesat kanë të njëjtin trajtim si objektet dhe legalizohen vetëm me miratimin paraprak të autoriteteve përgjegjëse sipas ligjit nr.27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", sipas procedurës së përcaktuar në këtë vendim.

11. Vendimi për legalizimin e ndërtimit pa leje bëhet i ekzekutueshëm dhe i regjistrueshëm në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasi të jetë plotësuar një nga kushtet e mëposhtme:

a) Të ketë kaluar afati 30-ditor i paraqitjes së ankimit administrativ ndaj vendimit dhe ndaj tij nuk është paraqitur ndonjë ankim. Afati i ankimit llogaritet nga data e njoftimit të vendimit; ose

b) Të ketë përfunduar shqyrtimi i ankimit nga struktura e posaçme për ankimet në Drejtorinë e Përgjithshme dhe vendimi të jetë lënë në fuqi, ose të jetë vendosur mospranimi i ankimit; ose

c) Në rastet kur struktura e posaçme për ankimet vendos për ndryshimin e përmbajtjes së vendimit të drejtorisë vendore, ose shfuqizimin, apo anulimin e pjesshëm të tij, ekzekutimi kryhet pasi drejtoria vendore të ketë miratuar vendimin e ri.

Për zbatimin e kësaj pike, drejtoria vendore është e detyruar të kërkojë informacion në rrugë elektronike pranë strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme, përpara se të vijojë me procedurën e regjistrimit.

12. Regjistrimi kryhet nga drejtoria vendore e ASHK-së, pa u kushtëzuar nga aplikimi për shërbim kadastral dhe nga parapagimi i tarifave kadastrale. Pas kryerjes së shërbimit të regjistrimit ajo njofton subjektin përfitues për të shlyer tarifën e regjistrimit dhe tarifat e tjera për t'u pajisur me aktet kadastrale, si: certifikatë regjistrimi pronësie, kopje kartele, kopje të fragmentit të hartës kadastrale.

13. Ekzekutimi i vendimit për moslegalizim, përveç shterimit të ankimit administrativ sipas pikës 11, të këtij vendimi, mund të varet edhe nga plotësimi i kushteve të veçanta në favor të poseduesit të ndërtimit, që përcakton Këshilli i Ministrave në vendimin e parashikuar sipas pikës 2, të nenit 33, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".

Pavarësisht parashikimeve të mësipërme, kur moslegalizimi vjen si pasojë e zbatimit të veprave ose projekteve që përbëjnë interes publik, në kuptim të legjislacionit për shpronësimet për interes publik, ose sepse ndërtimi pa leje cenon sigurinë e jetës, shëndetit, të vetë poseduesit apo të të tretëve ose pasurinë e tyre, atëherë vendimi për moslegalizim mund të ekzekutohet menjëherë, me kushtin që institucioni përgjegjës për veprën/projektin publik ta ketë kërkuar shprehimisht ekzekutimin e mënjëhershëm.

14. Përveç ankimit administrativ, vendimet e legalizimit/moslegalizimit të ndërtimeve pa leje mund t'i nënshtrohen kontrollit administrativ edhe kryesisht nga vetë ASHK-ja, nëse ajo vjen në dijeni për aktin, në përputhje me parimet dhe rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

II. KRITERET PËR LEGALIZIMIN E OBJEKTEVE PA LEJE NË ZONAT INFORMALE DHE ZONAT URBANE

15. Ndërtimi pa leje i llojit "objekt", i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar ose të zonës urbane, i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, nuk legalizohet nëse verifikohet një nga rastet e mëposhtme:

a) Shkel trupin e rrugës ekzistuese të kategorizuar si A, B, C, D, ose E;

b) Cenon sistemin ose shkel brezin mbrojtës të vijës hekurudhore ekzistuese funksionale, të nivelit kombëtar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.142/2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë";

c) Është ngritur brenda "territorit të ndërtesave publike" ekzistuese apo cenon funksionalitetin e tyre, sipas nenit 18, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", me përjashtim të rasteve kur është ndërtuar nga vetë këto institucione;

ç) Është ngritur në zonën e sigurisë të centraleve prodhuese të energjisë elektrike dhe nënstacioneve elektrike ose shkel brezin mbrojtës të sistemit të linjave ekzistuese të interkonjeksionit, sipas përcaktimeve të ligjit nr.43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar;

d) Është ngritur në territore të destinuara për investime strategjike, sipas përcaktimeve të ligjit nr.55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

dh) Cenon vëllimin ose pamjen e jashtme të monumentit të kulturës së kategorisë I ose është ngritur brenda zonës mbrojtëse të tij, sipas parashikimeve të ligjit nr.27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

e) Cenon pamjen e jashtme të monumentit të kulturës të kategorisë II, sipas përcaktimeve të ligjit nr.27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij;

Përjashtimisht, legalizimi do të lejohet vetëm me miratimin paraprak të autoriteteve përgjegjëse, sipas ligjit nr.27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë". Këto autoritete duhet të shprehen për vijimin ose jo të procedurës së legalizimit, në kuptim të cenimit të vlerave të trashëgimisë kulturore, brenda 60 ditëve nga data e kërkesës së drejtorisë vendore të ASHK-së;

ë) Në bazë të vlerësimit të autoriteteve përgjegjëse sipas ligjit nr.27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", cenon integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme të grupuara, të shpallura sipas kategorive të mëposhtme:

i. Kompleks;

ii. Ansambël-arkitektonik/urban;

iii. Qendër historike;

iv. Zonë arkeologjike "A",

Përjashtimisht, në rast cenimi të pasurive kulturore të sipërpërmendura, legalizimi lejohet vetëm nëse integriteti i tyre do të rrezikohej edhe nga prishja e objektit pa leje, mbi bazën e ekspertizës teknike përkatëse.

Këto autoritete duhet të shprehen për vijimin ose jo të procedurës së legalizimit, në kuptim të cenimit të vlerave të trashëgimisë kulturore, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e kërkesës së drejtorisë vendore të ASHK-së.

f) Është ngritur brenda sipërfaqes së truallit funksional të ndërtesave, objekt kulti, përveç rasteve kur poseduesi/subjekti ndërtues është vetë institucioni fetar dhe objekti informal është në funksion të këtij institucioni;

g) Është ngritur mbi ose shkel brezin mbrojtës të tubacionit të gazsjellësit, naftësjellësit, puseve të nxjerrjes së naftës dhe infrastrukturës së tyre, rrjeteve kryesore të ujësjellësve, aeroportit, portit apo cenon sigurinë e digave të mëdha, të mbrojtura sipas legjislacionit në fuqi;

gj) Preket nga zbatimi i një projekti konkret të infrastrukturës rrugore, ose të linjës energjetike të interkonjeksionit, të miratuar në mënyrë të posaçme nga Këshilli Kombëtar i Territorit;

h) Autoriteti vendor ose institucioni shtetëror kompetent, për zbatimin e një projekti që përbën interes publik, në kuptim të legjislacionit për shpronësimet për interes publik, ka paraqitur kërkesë të argumentuar për përjashtim nga legalizimi, përpara se ASHK-ja të ketë miratuar legalizimin;

i) Drejtorisë vendore të ASHK-së i është njoftuar vendimi gjyqësor i formës së prerë, me të cilin është vendosur pranimi i padisë së kthimit të sendit, sipas pikës 1, të nenit 28, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".

16. Përveç rasteve të përcaktuara në pikën 15, të këtij vendimi, ndërtimi pa leje nuk legalizohet edhe kur subjekti nuk plotëson dhe as dorëzon dokumentacionin e detyrueshëm për legalizim, si dhe kur heq dorë nëpërmjet një deklarate noteriale nga e drejta për të përfituar nga procesi i legalizimit, pa ia kaluar atë të tretëve, sipas pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".

17. Ndërtimet pa leje, që janë ngritur në territorin e parkut arkeologjik ose zonës arkeologjike "B" dhe që ndodhen brenda zonave informale ose zonave urbane, legalizohen pa nevojën e miratimit nga autoritetet përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

III.KRITERET PËR LEGALIZIMIN E OBJEKTEVE PA LEJE JASHTË ZONAVE INFORMALE DHE ZONAVE URBANE

18. Ndërtimi informal i llojit "objekt", i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", dhe që është ngritur jashtë vijës kufizuese të zonës informale të miratuar dhe jashtë zonës urbane, nuk legalizohet kur:

a) gjendet në kushtet përjashtuese sipas përcaktimeve të pikave 15 dhe 16, të këtij vendimi;

b) shkel distancat ndaj rrugëve ekzistuese, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

i. 40 metra për rrugët e kategorisë A;

ii. 30 metra për rrugët e kategorisë B.

Përjashtimisht nga sa është përcaktuar më sipër, kur akset e kategorive "A" dhe "B" janë të shoqëruara me rrugë dytësore, atëherë objektet pa leje që gjenden pranë tyre duhet të respektojnë vetëm trupin e rrugës dytësore, pa iu nënshtruar kriterit të distancës prej aksit kryesor.

c) është ngritur brenda kufirit të zonës ekonomike ekzistuese, të miratuar sipas ligjit nr.9789, datë 19.7.2007, "Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike", dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

ç) cenon integritetin e parkut arkeologjik;

d) është ngritur në zonat arkeologjike "B", të shpallura me vendim të Këshillit të Ministrave dhe për të cilat nuk është miratuar vijimi i procedurës së legalizimit nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale.

Në zbatim të kësaj shkronje, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale duhet të shprehet për vijimin ose jo të procedurës së legalizimit, në kuptim të cenimit të vlerave të trashëgimisë kulturore, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e kërkesës së drejtorisë vendore të ASHK-së.

dh) është ngritur përbri brigjeve të deteve, liqeneve, lumenjve, rezervuareve apo çdo sipërfaqeje tjetër ujore, kur këto janë territore ku nuk lejohen ndërtime, në bazë të planit të

përgjithshëm vendor në fuqi. Kur në PPV është përcaktuar brezi mbrojtës nëpërmjet "vijës blu", atëherë drejtoritë vendore të ASHK-së mbështeten në këtë të fundit;

e) është ngritur brenda territorit të zonës së mbrojtur, ku shkalla e mbrojtjes nuk lejon ndërtime me funksion banimi apo social-ekonomik, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.81/2017, "Për zonat e mbrojtura", planin e menaxhimit të zonës së mbrojtur dhe zonimin e brendshëm. Përjashtimisht, ndërtimi pa leje kualifikohet për legalizim, kur shkalla e mbrojtjes është rishikuar ose kur lejohen ndërtime, sipas akteve nënligjore të miratuara nga autoritetet përgjegjëse për zonat e mbrojtura;

ë) është ngritur brenda brezit mbrojtës të sistemeve kryesore të ujitjes dhe kullimit, të mbrojtura sipas ligjit nr.24/2017, "Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit", si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

f) me kërkesë të subjektit të interesuar provohet nga evidentimi faktik në terren se objekti cenon integritetin strukturor dhe/ose funksional të ndërtesës private, në pronësi të kërkuesit.

19. Ndërtimet pa leje, që gjenden brenda vijës bregdetare, por jashtë zonave informale dhe zonave urbane, si dhe jashtë zonave të stimuluara, përveç kritereve të legalizimit sipas dispozitave të tjera të këtij vendimi, u nënshtrohen edhe kushteve të infrastrukturës rrugore, të parashikuara në dokumentet e miratuara të planifikimit të territorit.

Përjashtimisht, kur nga zbatimi i projektit të infrastrukturës rrugore rezulton se ndërtimi informal nuk cenon veprën, atëherë ai legalizohet.

IV. PROCEDURAT DHE DOKUMENTACIONI PËR KUALIFIKIMIN E NDËRTIMEVE INFORMALE

20. Me përjashtim të rasteve të pezullimit sipas neneve 17, pika 5, 27, pika 2, 28 dhe 29, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", drejtoria vendore e ASHK-së është e detyruar të dalë me vendim për legalizimin ose jo të ndërtimit pa leje, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e evidentimit në terren, sipas datës së aktit të evidentimit në terren.

21. Aktekspertiza, deklarata noteriale, sipas nenit 23, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", deklatara për funksionin e ndërtimit të papërfunduar dhe deklarata për shembjen e objektit, kur janë të nevojshme, sipas ligjit dhe këtij vendimi, nuk përbëjnë kusht të domosdoshëm për përfundimin e procedurës administrative. Barrën procedurale për depozitimin e tyre e ka vetë poseduesi i ndërtimit dhe drejtoria vendore njofton brenda 5 (pesë) ditësh nga data e evidentimit në terren poseduesin për të dorëzuar këto akte, nëse janë të nevojshme.

Nëse poseduesi nuk dorëzon brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi, aktekspertizën apo deklaratën e shembjes së objektit ose dokumentacionin për shqyrtimin sipas pikës 28, të këtij vendimi, kur ai është i nevojshëm, drejtoria vendore pezullon procedurën administrative të legalizimit. Drejtoria vendore e ASHK-së vendos përfundimisht moslegalizimin e ndërtimit, kur këto akte nuk dorëzohen brenda 1 (një) viti nga data e pezullimit të procedurës administrative.

Mosdorëzimi i deklaratës për zgjedhjen e objektit apo për funksionin e ndërtimit të papërfunduar, brenda afatit 30-ditor, përbën shkak që ASHK-ja të veprojë respektivisht sipas pikës 2, të nenit 23, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", ose sipas vendimit të Këshillit të Ministrave që miratohet në bazë të nenit 17, të ligjit të sipërpërmendur.

22. Në rastet e procedurës së përshpejtuar sipas kërkesës së subjektit, drejtoria vendore është e detyruar të përmbyllë të gjithë procedurën administrative, përfshirë evidentimin në terren dhe vendimmarrjen brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e depozitimit të kërkesës dhe pagesa e tarifës së shërbimit shtesë. Drejtoria vendore zbaton këtë afat, me kusht që poseduesi bashkë me depozitimin e kërkesës për përshpejtim dhe shlyerjen e tarifës së diferencuar të ketë dorëzuar edhe dokumentacionin e përcaktuar në pikën 21, të këtij vendimi, nëse ai është i nevojshëm.

23. Procedurat administrative për legalizimin e ndërtimit pa leje nuk pezullohen sipas neneve 17, pika 5, 27, pika 2, 28 dhe 29, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", apo sipas dispozitave të tjera të këtij vendimi, në rast se ai preket nga një projekt ose vepër e infrastrukturës që përbën interes publik, në kuptim të legjislacionit për shpronësimet për interes publik ose nëse cenon

sigurinë e jetës, të shëndetit, të vetë poseduesit apo të të tretëve, apo pasurinë e tyre.

24. Për evidentimin e kufirit rrugor dhe trupit të rrugës, në raport me ndërtimin pa leje, drejtoritë vendore të ASHK-së duhet të mbështeten në:

a) dokumentacionin hartografik të certifikatës së përdorimit të nxjerrë në zbatim të legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, të cilin drejtoria vendore ia kërkon ARRSH-së ose autoriteteve të zhvillimit të territorit. Në mungesë të certifikatës së përdorimit, drejtoria vendore mbështetet në planvendosjen e shpronësimit, nëse ka të tillë;

b) evidentimin në terren të rrugës, kur mungon dokumentacioni i përcaktuar në shkronjën "a", të kësaj pike. Drejtoria vendore e ASHK-së harton procesverbalin e evidentimit të kufirit dhe trupit të rrugës në raport me ndërtimin pa leje, i cili miratohet nga drejtori i drejtorisë.

Në përfundim të verifikimeve të mësipërme, nëse rezulton se trupi i rrugës nuk është shkelur, ndërkohë që në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasuria figuron në mënyrë të gabuar si "rrugë", drejtoria vendore e ASHK-së është e detyruar të kryejë korrigjimin ose përmirësimin e hartës kadastrale dhe kartelës së pasurisë, në bazë të dokumentacionit të administruar sipas shkronjave "a" ose "b", të kësaj pike.

25. Të njëjtat rregulla si në pikën 24, të këtij vendimi, zbatohen edhe për evidentimin e veprave të tjera ekzistuese të infrastrukturës publike, që janë të parashikuara si kritere në dispozitat e këtij vendimi. Nëse është rasti, drejtoria vendore është e detyruar të kryejë korrigjimin ose përmirësimin e hartës kadastrale dhe kartelës së pasurisë.

26. Kur është e paqartë nëse ndërtimi pa leje gjendet ose jo në kushtet e shkronjës "c", të pikës 15, të këtij vendimi, atëherë drejtoria vendore e ASHK-së, për të identifikuar "territorin e ndërtesës publike", mbështetet në inventarin e pronave shtetërore ose, sipas rastit, në listën e pronave të transferuara te njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku përfshihet ndërtesa publike. Nëse prona nuk është e inventarizuar ose nëse këta inventarë apo lista nuk janë të shoqëruara me dokumentacion hartografik, drejtoria vendore mbështetet në dokumentacionin hartografik të disponuar nga AQTN-ja ose nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore. Në mungesë edhe të këtyre të fundit, identifikimi kryhet në bazë të evidentimit në terren.

Kur sipërfaqja e territorit të ndërtesës publike të inventarizuar rezulton të jetë më e vogël në terren sesa në inventar/listë dhe njëkohësisht poseduesi i ndërtimit pa leje nuk ka titull pronësie për truallin e parcelës ndërtimore, atëherë drejtoria vendore mban parasysh vlerën e sipërfaqes së përcaktuar në inventarin ose listën e pronave të transferuara, edhe nëse ato nuk përmbajnë dokumentacion hartografik.

Në përfundim të verifikimeve të mësipërme, nëse rezulton se territori i ndërtesës publike nuk është shkelur, ndërkohë që në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasuria figuron në mënyrë të gabuar si ndërtesë publike dhe/ose territor i saj, drejtoria vendore e ASHK-së është e detyruar të kryejë korrigjimin ose përmirësimin e hartës kadastrale dhe kartelës së pasurisë.

27. Në rastet kur, sipas këtij vendimi, lejohet legalizimi i ndërtimeve pa leje mbi trotuar, si pjesë e trupit të rrugës, atëherë drejtoria vendore e ASHK-së, pasi vendimi për legalizim të jetë bërë i ekzekutueshëm, është e detyruar të pasqyrojë ndryshimin e llojit të pasurisë në regjistrin e pasurive të paluajtshme nga "rrugë" në "truall", në bazë të nenit 32, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". I njëjti detyrim vlen edhe për të gjitha llojet e tjera të pasurive, të cilat nuk pengojnë legalizimin në bazë të kritereve të përcaktuara në këtë vendim, duke pasqyruar ndryshimin e tyre në regjistër, nga përcaktimi i mëparshëm në "truall".

28.Për zbatimin e dispozitave të këtij vendimi, që kërkojnë shprehjen e autoriteteve të trashëgimisë kulturore, drejtoria vendore e ASHK-së vendos në dispozicion të këtyre autoriteteve dokumentacionin e praktikës së legalizimit: genplan, planimetritë si dhe dokumentacionin që duhet të sigurohet nga vetë poseduesi i ndërtimit kur ai është i nevojshëm, sipas rastit: fotografi të ndërtimit, prerje teknike të objektit për legalizim, fasadat teknike dhe relacionin teknik. Të gjitha këto materiale dorëzohen pranë sekretarisë teknike të KKTKM-së me CD, shoqëruar me prezantim në format Powerpoint.

29. Për ndërtimet pa leje që nuk legalizohen sipas përcaktimeve të nenit 29, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të

pronësisë në Republikën e Shqipërisë", dhe të shkronjës |b", të pikës 2, të këtij vendimi, drejtoritë vendore të ASHK-së, në varësi të funksionit të ndërtimit procedojnë, si më poshtë vijon:

a) Pezullojnë procedurën administrative për objektin me funksion banimi dhe vendosin moslegalizimin vetëm pas plotësimit të kushteve të parashikuara në pikën 3 të të njëjtit nen; ose

b) Miratojnë vendimin për moslegalizim, sipas afatit të pikës 20, të këtij vendimi, për objektin me funksion social-ekonomik. I njëjti rregull zbatohet edhe për objektet me funksion të papërcaktueshëm nga evidentimi në terren.

30. Vendimi i legalizimit/moslegalizimit të ndërtimit, shoqëruar me dokumentacionin teknik, i njoftohet subjektit përfitues brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e miratimit të aktit. Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", vendimi i legalizimit është edhe akti administrativ për kalimin e pronësisë mbi parcelën ndërtimore.

31. Lista e subjekteve përfituese të ndërtimeve të legalizuara, shoqëruar me të dhënat e pasurive, si adresa, zona kadastrale, numri i pasurisë, publikohet në ambientet e ASHK-së, pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, si dhe në faqen zyrtare të internetit të ASHK-së.

32. Subjektet e interesuara, në përputhje me afatet e përcaktuara në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, kanë të drejtë të paraqesin ankim administrativ për vendimin e legalizimit, pranë strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së.

33. Në përputhje me nenet 141 dhe 144, të Kodit Civil, si dhe me nenin 560, të Kodit të Procedurës Civile, ndërtimi pa leje nuk përbën objekt të ekzekutimit të detyrueshëm dhe legalizimi i tij nuk ndërpritet për shkak të këtyre procedurave.

34. Kur poseduesi e ka ngritur ndërtimin në pronën e tij dhe kjo pronë rezulton e sekuestruar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni për këtë fakt, drejtoria vendore e ASHK-së kryen procedurat për legalizimin e ndërtimit nëse përmbushen kriteret dhe njofton përmbaruesin gjyqësor përpara regjistrimit të pasurisë së legalizuar. Përjashtimisht, nëse si pasojë e ekzekutimit të detyrueshëm të kredisë, poseduesi e ka humbur pronësinë e tij mbi truallin përpara vendimit të legalizimit, kjo procedurë vijon vetëm me miratimin paraprak të subjektit që ka fituar pronësinë mbi truallin ose pasi konflikti për të drejtat mbi ndërtimin pa leje të jetë zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë.

35. Në rastin e pikës 34, të këtij vendimi, përfshirë edhe rastet kur trualli në pronësi të poseduesit të ndërtimit është vetëm i hipotekuar pa filluar ende ekzekutimi i detyrueshëm, si dhe në çdo rast kur poseduesi është subjekt i ekzekutimit të detyrueshëm të një kredie, drejtoria vendore e ASHK-së, gjatë legalizimit, nuk merr parasysh asnjë veprim juridiko-civil për kalimin te të tretët të të drejtave mbi ndërtimin pa leje.

36. Kur poseduesi i ndërtimit pa leje nuk është pronar i truallit dhe nuk është në cilësinë e debitorit ndaj të cilit po zbatohet ekzekutimi i detyrueshëm i kredisë, sekuestroja që rëndon mbi truallin nuk pengon legalizimin dhe kompensimin sipas nenit 24, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". Ekzekutimi i detyrueshëm në këtë rast vijon mbi shumën e kompensimit që vendoset në llogarinë bankare të posacme sipas nenit të sipërpërmendur.

37. Ekzekutimi i detyrueshëm nuk pengon procedurat e legalizimit as në rastin e objekteve me shkelje të lejes së ndërtimit. Kur objekti me shkelje të lejes dhe/ose trualli rezulton i sekuestruar, drejtoria vendore e ASHK-së procedon sipas përcaktimeve të dispozitave të mësipërme.

Nëse ekzekutimi i detyrueshëm i debisë së investitorit ka përfunduar më parë dhe karabinaja është tjetërsuar, objekti legalizohet në favor të subjektit që e ka përfituar atë, vetëm për ato njësi për të cilat nuk janë lidhur më parë akte noteriale mes investitorit dhe porositësve apo pronarëve të truallit.

Nëse përmbaruesi pengon legalizimin apo pretendon pezullimin e procedurave, në kundërshtim me pikat 33 deri në 37, të këtij vendimi, ASHK-ja njofton ministrin e Drejtësisë për nisjen e procedimit disiplinor.

38. Nëse poseduesi ka ngritur ndërtim informal mbi truallin e një objekti të shembur, që ka qenë në pronësi të tij, ai duhet të dorëzojë pranë drejtorisë vendore të ASHK-së deklaratën noteriale në të cilën pranon faktin e shembjes. Kjo deklaratë dorëzohet përpara miratimit të lejes së legalizimit, sipas afatit dhe procedurës së përcaktuar në pikën

21, të këtij vendimi. Në të kundërt, ndërtimi përjashtohet nga legalizimi.

Kur objekti i shembur rezulton në pronësi të të tretëve ose në pronësi shtetërore, sipas dokumentacionit ligjor të fitimit të pronësisë, atëherë në deklaratën noteriale poseduesi duhet të deklarojë se nuk është subjekt i veprave penale të parashikuara në seksionin III, të kreut III, të pjesës së posaçme, të Kodit Penal.

Për ndërtimet shtetërore të shembura, institucioni përgjegjës (administrues), ose njësia e vetëqeverisjes vendore, pas konfirmimit të shembjes, detyrohet të kryejë procedurat e përditësimit të listës së pasurive të paluajtshme të shtetit, në përputhje me kreun IV, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", pa penguar apo kushtëzuar përfundimin e procedurave të legalizimit dhe regjistrimit të pasurisë së legalizuar.

39. Nëse gjatë procedurave administrative për legalizim konstatohet se ndërtimi është inventarizuar/transferuar si pronë shtetërore në mënyrë të gabuar, pas konfirmimit shkresor nga institucioni qendror ose këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, drejtoria vendore miraton vendimin e legalizimit dhe vijon me regjistrimin e tij.

40. Nëse ndërtimi sipas pikës 39, të këtij vendimi, është edhe i regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme, drejtoria vendore e ASHK-së korrigjon regjistrin, duke hequr nga kartela pronësinë e shtetit/Republikës së Shqipërisë ose të njësisë së vetëqeverisjes vendore, si dhe regjistron aktin e legalizimit të nxjerrë sipas këtij vendimi.

Njëkohësisht, institucioni qendror apo njësia e vetëqeverisjes vendore nis procedurën e përditësimit të pjesshëm të listës së pronave shtetërore sipas kreut IV, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", pa penguar regjistrimin e dokumentit të pronësisë, të miratuar sipas këtij vendimi.

Nëse sipërfaqja ndërtimore e ndërtimit pa leje është pasqyruar në regjistër në pronësi të shtetit, ndërkohë që ai nuk është as në listën e pronave shtetërore dhe nuk është administruar as akt tjetër i fitimit të pronësisë së shtetit, sipas Kodit Civil, drejtoria vendore e ASHK-së është e detyruar të bëjë kryesisht korrigjimin e kartelës. Korrigjimi kryhet sipas nenit 16, të ligjit nr.111/2018, "Për kadastrën", duke hequr shënimin e sipërfaqes ndërtimore në pronësi shtetërore dhe duke pasqyruar aktin e legalizimit, të nxjerrë sipas këtij vendimi. Ky rregull zbatohet edhe në rastet e tjera kur janë kryer regjistrime të gabuara të ndërtimeve "shtet" pa dokument ligjor, vetëm mbi bazën e librit të ngastrave.

41. Kur parcelat ndërtimore, të cilat gjenden në troje në përgjegjësi administrimi të institucioneve shtetërore ose të transferuara te njësitë e vetëqeverisjes vendore, drejtoria vendore e ASHK-së vijon me legalizimin e ndërtimit dhe regjistrimin e tij dhe të kalimit të pronësisë mbi parcelën, duke njoftuar këto institucione. Njoftimi ka vetëm karakter njohës dhe procedurat e legalizimit dhe regjistrimit të pasurisë së legalizuar nuk kushtëzohen nga pëlqimi i këtyre institucioneve, në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

42. Aktet e përjashtimit nga legalizimi të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, rishikohen sipas kreut IV, të pjesës së gjashtë të Kodit të Procedurave Administrative, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 18, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", dhe në këtë vendim, nëse këto të fundit ose ndryshimi i rrethanave të faktit mundësojnë kualifikimin e ndërtimeve për legalizim. Rishikimi lejohet me kusht që për ndërtimin të mos jetë vendosur më parë prishja nga autoritetet e kontrollit të zhvillimit të territorit ose ky dënim të jetë parashkruar sipas nenit 46, të ligjit nr.10279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative", apo të jetë shfuqizuar, anuluar ose konstatuar i pavlefshëm në rrugë administrative ose gjyqësore.

43. Aktet e përjashtimit nga legalizimi të miratuara përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.50/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të shfuqizuar, për ndërtimet pa leje të cilat gjendeshin në kushtet e pikës 4, të nenit 2, të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të shfuqizuar, dhe që aktualisht

kanë funksion social-ekonomik ose funksion të papërcaktueshëm, i njoftohen për ekzekutim autoriteteve të kontrollit të zhvillimit të territorit dhe poseduesit e tyre trajtohen sipas nenit 33, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". Për këtë qëllim, drejtoria vendore e ASHK-së mbështetet në funksionin aktual të ndërtimit sipas terrenit, duke e verifikuar atë përpara njoftimit të autoriteteve të kontrollit të zhvillimit të territorit.

44. Aktet e kualifikimit, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nëpërmjet të cilave është vendosur kualifikimi i ndërtimeve pa leje, në përputhje me legjislacionin dhe faktet e kohës, merren të mirëqena. Për këto ndërtime, që janë të pranishme në terren, drejtoritë vendore të ASHK-së miratojnë aktin e legalizimit, sipas modelit të këtij vendimi, duke u mbështetur në kualifikimin e kryer më parë, pavarësisht se si qëndron ndërtimi në raport me kriteret ligjore dhe faktet aktuale. Fakti i kualifikimit të kryer më parë parashtrohet në pjesët përshkruese dhe arsyetuese të aktit të legalizimit.

45. Lejet e legalizimit të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, në përputhje me legjislacionin e kohës, por të paregjistruara, regjistrohen në përputhje me dispozitat e kreut III, seksioni 1 dhe me pikën 2, të nenit 69, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". Në bazë të nenit 32, të këtij ligji, në rastet kur ndërtimi dhe parcela ndërtimore shtrihen mbi pasuri jo të llojit "truall", drejtoria vendore e ASHK-së është e detyruar të vijojë me regjistrimin e pasurisë së legalizuar (ndërtimit dhe parcelës) duke pasqyruar ndryshimin e llojit të pasurisë në regjistër, nga lloji i mëparshëm, në "truall", në të njëjtën mënyrë si në pikën 27, të këtij vendimi.

46. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.280, datë 1.4.2015, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore, dhe/ose në lartësi, në ndërtimet me leje", të ndryshuar, si dhe nr.954, datë 25.11.2015, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të formularit të lejes së legalizimit", të ndryshuar, shfuqizohen.

47. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës, institucionet qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2020 - Numri: 221
Datë: 2020/12/17 20:11:24
0b21c852-9bea-4e13-b136-991c5eadc03a

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

tt

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 288 lekë